

**IMAM MEHDIU
DHE LAJMET E DIJES
SË FSHEHTË, GAJBIT**

Tiranë, 2016

Titulli: **Imam Mehdiu dhe lajmet e dijes së Fshehtë, Gajbit**

Autori: **Sejjid Hasan Nasrullah**

Përktheu: **Vullnet Merja**

Recensent: **Sabrie Feza**

Redaktoi: **Esat Bunguri**

Përgatiti për shtyp: **Sabrie Feza**

Kopertina: **Sabrie Feza**

Botoi: **Shoqata "FLLADI"**

PARATHËNIE

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të nderuarin tonë, Muhamedin dhe mbi familjen e tij të pastër.

Ky libër përmban një cikël leksionesh të rëndësishme intelektuale. Këto leksione i ka mbajtur sekretari i përgjithshëm i Hizbullahut, eminenca e tij, dijetar Hasan Nasrullah, (Allahu e ruajtë!), gjatë netëve të Ashurasë në vitin 1436 hixhri. Në këto leksione ai ka trajtuar rrjedhshëm, imtësisht, thellësisht dhe me një metodikë të qartë çështjen e Imam Mehdiut, (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), si dhe lajmet e dijes së fshehtë. Duke parë rëndësinë e këtyre temave dhe nevojën konkrete për to, ne vendosëm që t'i shkruajmë dhe t'i botojmë këto leksione në këtë studim me qëllim që të përfitojmë të gjithë prej tyre.

HULUMTIMI I PARË

NJË PIKËPAMJE PËR MËNYRAT E NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË¹

Hyrje

Gjatë gjithë historisë njerëzore është vënë re interesi i madh i njerëzimit për të patur informacionin e nevojshëm për ç'mund të ndodhë në ditët dhe vitet e ardhshme, në dekadat dhe shekujt e ardhshëm, deri sa të bëhet Kijameti. Kjo temë tërheq edhe më shumë vëmendjen në kohëra të ngarkuara me probleme dhe sprova të mëdha, sepse njerëzit në kohëra të vështira kërkojnë ndonjë derë për t'u çliruar, për të gjetur dalje nga këto rrugë pa krye dhe me kriza duke bërë parashikime dhe profeci. E gjithë kjo emërtohet me emrin "dije të fshehta."

¹ Fjala e eminencës së tij i nderuari Hasan Nasrullah (Allahu e ruajtë!) në tubimet e Ashurasë, natën e pestë të muajti Muharrem, viti 1436 h - 29/10/2014.

Në qoftë se do të shfletojmë faqet e historisë, do të gjejmë sulltanë, mbretër e ushtri që kanë vepruar duke besuar këto gjëra. Është e sigurtë se Beni Israilët dhe çifutët në përgjithësi kanë trashëguar një pasuri të madhe me lajme të fshehtësisë dhe të së ardhmes, sepse atyre u kanë shkuar një numër i madh pejgamberësh. Kur një pejgamber tregonte një apo dy histori, ata i mblidhnin dhe i ruanin. Kur ishin në vështirësi, sidomos nga robëria babilonase², ata drejtoheshin te pejgamberët për t'i pyetur se si mund të dilnin nga situata e vështirë, apo si mund të lehtësoheshin dhe pejgamberët i lajmëronin ata për disa çështje të mundshme.

² Robëria Babilonase: është një periudhë kohe në historinë çifute, e cila në këtë kohë është bërë robërimi i mbretërisë së lashtë Jehudha nga dora e Nebuhadh Nasr Al-Kandi në babiloni dhe në Irak, duke e zbazuar dhe evakuuar Palestinën dy here nga çifutët.

DIJA E FSHEHTË DHE E ARDHMJA JANË NJË ÇËSHTJE E DEBATUESHME DHE E RËNDËSISHME

Nostradamusi është i njohur si një parashikues³ i cili hiqet sikur ka perceptime për lajmet e dijes së fshehtë, madje edhe për luftën botërore. Palët në konflikt përfituan nga perceptimet dhe profecitë e tij, të cilat u përhapën mes njerëzve me komentimet dhe interpretimet e tyre. Prej këtyre profecish është përfituar edhe në luftën e informacionit e të mediave. Ndërsa tani, me zhvillimin e mjeteve të ndërlidhjes dhe të informacionit, tema është bërë edhe më e njohur, edhe më e famshme. Tani, si rrjedhim i zhvillimeve gjigande e të rrezikshme këto profeci po i shikon bota, po i shikojnë dy botët, edhe ajo arabe, edhe ajo islame. Në disa vende ky informacion, këto profeci shfrytëzohen në forma të ndryshme, si për shembull: Një pjesë e njerëzve mbështeten tek lajmet që flasin se ç’do të ndodhë në të ardhmen. Këtë e bëjnë për të argumentuar se rruga e tyre është rruga e vërtetë, se vendimi i tyre për zgjedhjet përkatëse është i drejtë. Një pjesë tjetër i shfrytëzojnë këto informacione për të folur për fitoret dhe triumfet e tyre. Nuk është kusht që të flitet për

³ Nostradamus: është një parashikues francez i cili ka publikuar një numër të madh parashikimesh në librin e tij (Profecitë).

transmetimet specifike të sahabeve dhe të të Dërguarit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), me qëllim që të mos thuhet për ata se janë fallxhorë apo parashikues. Përkundrazi, këto përdoren në luftën psikologjike të Xhorxh Bushit dhe Reganit.⁴ Të dy imagjinonin se presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ose të paktën një pjesë e tyre kanë ndërtuar projekte gjigande në bazë të këtyre profecive, duke bërë që këto informacione të bëhen subjekte informues dhe investues që sjellin fitime të mëdha.

Diskutimi rreth kësaj çështjeje është bërë një temë normale, prandaj ne nuk mund t'u themi njerëzve të mos i ndjekin lajmet që flasin për të ardhmen, edhe Kur'ani ka lajmëruar për të ardhmen. Muslimanët kanë në duart e tyre pasuri gjigande transmetimesh nga i Dërguari, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) Gjithë informacioni që përcjellin librat e muslimanëve lidhur me ngjarjet e së ardhmes, apo për Fundin e Botës, është një temë që kërkon trajtim tepër të kujdesshëm, veçanërisht kur çështja arrin deri në një problem shumë të rëndësishëm, si çështja e Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), çështja e të pritshmit. Një pjesë e shiijave, disa dijetarë thonë **se ai ka lindur**. Vëllezërit tanë të ehli synetit thonë **se ai akoma nuk ka lindur dhe kur ai të arrijë moshën dyzet vjeçare do të vërtetohen këto lajmërimet që përmenden nëpër hadithe**. Po të veçojmë nga

⁴ Ish -presidentët e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

këto hadithe lajmet që lidhen me Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), lajmet e tjera kanë lidhje me të ardhmen. Kjo është një nga çështjet me të cilën njerëzit do të sprovohen, është çështja për të cilën do të pyesim njëritjetrit, por edhe do të luftojmë kundër njëritjetrit.

Unë desha që këtë natë dhe natën që vjen ta trajtoj këtë temë, sepse i preokupon shumë njerëzit. Kjo nuk është një temë teorike, përkundrazi, kjo temë është e pranishme në media dhe në libra, prandaj dëshirojmë të dijmë se cili është orientimi islam në lidhje me këtë çështje. Sot do të flas për një pjesë të saj dhe pjesë të tjera do t'i plotësojmë në netët në vijim.

ÇFARË ËSHTË DIJA E FSHEHTË, GAJBI?

Të shkUARËN e kemi lënë pas. E ardhmja po afrohet, kurse tani jemi në të tashmen. Enigmat e të fshehtës nuk i dimë, prandaj ne nuk e kemi dëshmuar të ardhmen, por vetëm e presim atë. Kush dëshiron që të japë lajme për të ardhmen, duhet të ketë dituri për të fshehtën, sepse e ardhmja është pjesë e dijes së fshehtë. Bota e fshehtë dhe bota e dëshmisë egzistojnë. Bota e dëshmisë është ajo që ne shikojmë dhe që mund ta prekim me shqisat tona, kurse bota e së fshehtës është ajo që nuk mund të preket nga shqisat tona, është e panjohur. Ajo gjë që nuk është konkrete është pjesë e dijes së fshehtë. Kurse bota e dëshmisë është gjithçka që shikohet dhe preket. Bota e padukshme është ajo që qëndron pas shqisave, është gjithçka që lidhet me Krijuesin e Lartësuar, që lidhet me shpalljen që ka dërguar Allahu i Madhëruar, në lidhje me engjëjt, me vdekjen dhe me atë çfarë ndodh pas vdekjes, me varrin, me Barzakhun, me tmerret e Kijametit dhe situatat e tij, me shpërblimin, me ndëshkimin, me Xhennetin, me Xhehennemin. E gjithë kjo është pjesë e dijes së fshehtë. Kështu, për shembull, për zanafillën e krijimit, pavarësisht zhvillimeve shkencore, të cilat hedhin dritë rreth saj, vërtiten teori të shumta. Të vërteta të padiskutueshme dhe të sigurta janë ato që tregojnë

mënyrën se si Allahu i Madhëruar e ka krijuar universin, njeriun, kafshët, Ademin, Havanë, Xhennetin dhe Zjarrin. Por këto janë pjesë e dijes së fshehtë, pra, mbartin një të fshehtë e cila ka lidhje me të shkuarën dhe me të ardhmen. Këto ne i quajmë rrethanat e dijeve të fshehta, të cilat do të zhvillohen në univers. Ato mbartin informacionet se çfarë do t'i ndodhë universit dhe jetës në tërësi, se ç'do t'i ndodhë njeriut, si do të përfundojë qënia njerëzore. Të gjitha këto pyetje kanë lidhje me të ardhmen dhe njoftimi për të ardhmen lidhet me dijen e fshehtë.

BESIMI NË GAJB, NË DIJEN E FSHEHTË ËSHTË PJESË E BESIMIT TONË

Ne besojmë në gajb, në dijen e fshehtë dhe kjo është pjesë e doktrinës së të gjithë pejgamberëve, (Paqja qoftë mbi të gjithë ata!), prandaj kur ne themi “Krijuesi, Kijameti, shpallja dhe engjëjt”, duhen kuptuar se të gjitha këto janë pjesë e gajbit, dijes së fshehtë. Ne e besojmë atë dhe kjo gjë në besimin islam është e qartë, thotë Allahu i Madhërueshëm: “**Elif, Lam, Mim. Ky është Libri që nuk ka dyshim në të, (sepse është prej Allahut), është udhëzues për ata që janë të devotshëm. Ata që e besojnë të fshehtën (cilësia e parë e të devotshmëve është besimi i të fshehtës), e kryejnë faljen, (namazin) dhe prej asaj që Ne u kemi dhënë ata japin (zeqat, sadaka, etj). Dhe ata që besojnë në atë që të është zbritur ty, (Kur'anin), (ajo që i ka zbritur të Dërguarit të Allahut është një pjesë e së fshehtës) dhe në atë që është zbritur para teje (është gjithashtu një pjesë e së fshehtës) dhe që janë bindur plotësisht për (jetën e ardhshme në), Botën Tjetër.” (përsëri dije e fshetë).⁵**

⁵ Sure "Bekare", ajeti 4.

E FSHEHTA DHE DËSHMIA JANË DY ÇËSHTJE RELATIVE

Mbetet për të treguar kujdes. Kjo ka të bëjë me të fshehtën dhe dëshminë. Këto janë dy pjesë të një çështje relative, të cilat lidhen me atë që se çfarë do të ndodhë sot dhe nesër? Ne nuk e dimë se ç' do të ndodhë sot, as nesër, sepse kjo është e fshehtë, mirëpo, nëqoftë se mbetemi gjallë deri të nesërmen, ajo që ka ndodhur nuk mbetet e fshehtë, bëhet fakt që dëshmon atë që ndodhi. Në këtë kontekst, edhe vdekja, edhe nxjerrja e shpirtit nga trupi, i përkasin të fshehtës, por kur njeriu vdes, kjo ngjarje kthehet në dëshmi që tregon atë ndodhi. Edhe Kijameti dhe gjithçka ndodh e përfshin dija e fshehtë, derisa një pjesë prej nesh të drejtohen drejt Xhennetit, kurse të tjerët drejt Zjarrit. Pas kësaj të gjitha këto të fshehta, kthehen në dëshmi dhe në prova.

DITURIA PËR TË FSHEHTËN

Me të drejtë mund të shtrohet pyetja: Kush është ai që e di të fshehtë, atë që do të ndodhë në të ardhmen në dynja, në univers, pas dynjasë, apo të fshehtë e shkuar?

Të gjitha të fshehtat kanë një referim. Kështu, i sëmuri shkon tek mjeku për të kërkuar të fshehtë e sëmundjes. Nëse duam të ndërtojmë shkojmë tek inxhinieri, nëse kemi punë me dru shkojmë te marangozi etj. Po nëse duam të njohim të fshehtë ku të shkojmë? Cili është ai që e njeh të ardhmen e cila është në vetvete një pjesë e së fshehtës?

Sipas Islamit, përgjigjia e prerë dhe definitive është: “Askush nuk e di të fshehtë, përveç Allahut të Madhëruar.” Ne si muslimanë nuk pohojmë as pretendojmë të themi se ndokush a ndonjë krijesë e gjallesë mund ta dijë të fshehtë.


Allahu i Lartësuar mundet të pajisë një pjesë të robëve të Tij me urtësi dhe mëshirë të caktuar që t’u shërbejnë interesave të njerëzve e pët t’i udhëzuar ato në rrugën e drejtë. Vetëm Allahu i Madhëruar mundet që t’u ekspozojë robëve të Tij një pjesë të fshehtësisë së Tij, por jo të gjithë diturinë e Tij. Allahu i Madhëruar nuk ia ka shfaqur askujt prej krijesave të Tij, askujt prej njerëzve dhe as engjëjve gjithçka Ai di. Allahu ka ruajtur për Vetën e Tij

dije dhe të fshehta që vetëm Ai, Allahu i Madhëruar në mënyrë absolute i di! Ato nuk ia ka shfaqur askujt!

Por cilës pjesë të robërve të Tij? Disa nga robt e Allahut të Madhëruar të cilëve u është shfaqur një pjesë e dijes së fshehtë të Allahut të Madhëruar janë pejgamberët dhe të dërguarit, si dhe një pjesë e engjëjve. Janë këta robt e Allahut, të cilët janë informuar për një pjesë së dijes së Tij, apo për një pjesë të dijes së fshehtë të Tij. Vetëm ata e dinë atë që ua ka mësuar Allahu. Ata dinë aq sa i ka informuar Ai dhe jo më shumë. Ata nuk pretendojnë më shumë se aq dhe ky është vetëm kufiri i temës. Allahu i Madhëruar thotë: **“Nga ajo që Ai di, të tjerët dinë vetëm aq sa Ai ka dëshiruar!”**⁶

Allahu i Lartësuar është Ai që e përcakton se kujt t’ia japë dijen, sasinë e diturisë, kufirin e dijes dhe mënyrën e dhënies, qoftë dije e fshehtë apo çfarëdo lloj dije qoftë. Pra, në raport me sasinë dhe kufijtë e dijes që fitojnë nga Allahu i Madhëruar edhe pejgamberët janë të ndryshëm, lidhur me atë që egziston deri Ditën e Kijametit.

⁶ Sure "Bekare", ajeti 255.



MËNYRAT E BESUESHME TË NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË

Për dijen e fshehtë dhe dijen e së ardhmes nuk ka asnjë rrugë tjetër të saktë, përveç asaj që i referohet burimit, Allahut të Lartësuar. Për shembull, ne e besojmë se Kur'ani Famëlartë është Libri i Allahut të Madhëruar, të cilin e zbriti në zemrën e peygamberit të Tij të fundit, Muhamedit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe kjo është dije prej Allahut të Madhëruar. Në Kur'an ka lajmërimë për të ardhmen dhe lajme për dijen e fshehtë, ka informacion për ato që do të ndodhin, kështu që ky informacion bëhet një burim i besueshëm dhe i sigurtë, kurse mënyra e kuptimit të ajeteve, është një hulumtim tjetër.

Edhe ajo që u pasua te peygamberët nga peygamberët e tjerë, ajo që ka dëgjuar brezi i parë nga i Dërguari i Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ajo që ne kemi mbërritur, si nëpërmjet Ehli Bejtit dhe ajo që është dëgjuar prej tyre, janë informacione të sigurta dhe të besueshme.

Kjo është rruga e vetme që njeriu ka në dispozicion. Vetëm këtu mund të mbështetet për të njohur të ardhmen sipas burimeve të sigurta, të vërteta dhe të besueshme dhe jo duke u mbështetur në imagjinata, në dyshime dhe

iluzione. Kjo është ana më e rëndësishme të cilën synoj, të cilës dua t'i referohem dhe ta analizoj. Ne dëshirojmë të përcaktojmë se si ta mësojmë, si të informohemi, cila është përgjegjësia jonë dhe si duhet t'i trajtojmë këto informacione që lidhen me të ardhmen dhe, në mënyrë të veçantë, ato që lidhen me fundin e kohës, me lajmet historike e të tjera si këto.

MULTIMËNYRAT E NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË

Para këtyre ka pasur shumë metoda të tjera që njerëzit e interesuar i kanë përdorur gjatë gjithë historisë, për të njohur të ardhmen. Disa prej tyre janë:

1-Astrologjia: Shumë njerëz e kanë studiuar shkencën e astrologjisë dhe të astronomisë. Këta astrologë dhe astronomë janë marrë me studimin e lëvizjes së planeteve, të yjeve, të hënës, me orbitat dhe rrugët e tyre dhe nëpërmjet leximit të lëvizjes së yjeve ata kanë arritur “të lexojnë” të ardhmen dhe thonë: filani do të vdesë në filan ditë, apo në këtë kohë do të ndodhë një luftë ose do ketë paqe, ose u thonë mbretërve: mos luftoni në filan vit ose luftoni në filan vit etj. Këto i sheh dhe i dëgjon çdo ditë nëpër media.

2-Hedhja e fallit me rërë⁷: Ka njerëz që shkojnë tek një person që hedh fall me rërë. Fallxhiu i thotë, për shembull, se ti do të kesh pesë fëmijë. Shëndeti i tyre do të jetë kështu e ashtu, emrat do t’i kenë kështu e ashtu. Ose i

⁷ Hedhja fall me rërë: është fall, një mënyrë për të mësuar të panjohurën; ajo mbështetet në pika të njëpasnjëshme pa numëruar në disa rreshta me rërë dhe pastaj pas kësaj nxirret prej saj leximi i dijes së fshehtë.

flet për biznes, merruni ose jo me filan biznes, e të tjera si këto.

3-Hedhja fall me shikim: Falli me shikim realizohet me shumë forma, si: leximi i pëllëmbës së dorës dhe i vizave të saj, apo shikimi i filxhanit të kafes etj.

4-Dija e numrave, e shkronjave dhe fjalive⁸: Ka fallxhorë që llogarisin shkronjat dhe fjalitë që formojnë një numër dhe me llogaritjet që bëjnë, dalin në përfundime se do të ndodhë kështu apo ashtu.

5-Nënshtrimi i xhindëve dhe përdorimi i tyre: Disa njerëz për shembull afrojnë xhindet dhe i pyesin. Xhindet u përgjigjen dhe e lajmërojnë atë për të ardhmen. Ai, sipas këtyre thënieve të xhindeve i lajmëron njerëzit. Por këtu ka një problem thelbësor, sepse një pjesë e njerëzve mendojnë se xhindët kanë dijeni për të fshehtën. **Duhet të qartësohet përfundimisht dhe prerë se xhindët nuk kanë dijeni për të fshehtën!** Përkundrazi, ata janë njësoj si njerëzit. Njerëzit flasim për çështje që janë të vërteta, ndërsa xhindët i analizojnë, por ata nuk e dinë të fshehtën. Allahu i Madhëruar në suren “Sebe” flet për xhindët dhe se si ata i bindeshin Sulejmanit (Paqja qoftë mbi të!), se si xhindët punonin dhe i shërbenin atij. Kur Sulejmani (Paqja qoftë

⁸ Llogaritja e fjalive: është një mënyrë e regjistrimit të pamjeve të numrave dhe datave duke përdorur shkronjat e alfabetit; ku secilës shkronjë i vihet një numër duke përcaktuar se tregon atë dhe me anë të formimit të këtyre shkronjave dhe serive të tyre arrinin në atë që nënkuptojmë një datë të synuar, e kundërta ndodhte me numrat që i përdornin për të arritur në leximin e tyre.

mbi të!), vdiq, duke qenë i mbështetur mbi shkopin e tij, xhindët akoma vazhdonin punën e tyre dhe nuk e dinin që Sulejmani kishte vdekur. Kjo zgjati derisa erdhi një krimb dhe filloi të hajë pak nga pak shkopin në të cilin ishte i mbështetur Sulejmani (Paqja qoftë mbi të!). Allahu i Madhëruar thotë: **“E kur ia caktuam atij vdekjen, askush tjetër nuk i njoftoi ata, (xhindët) për vdekjen e tij, përveç krimbit që e brejti shkopin e tij, e kur ai u rrëzua, për xhindët u bë e qartë se ai kishte vdekur. Sikur ata ta dinin të fshehtë, nuk do të vazhdonin të qëndronin në mundimin e rëndë.”**⁹

Sikur xhindët ta dinin të fshehtë do ta kuptonin se ai ka vdekur. Edhe vetë xhindët e dinë se ata nuk kanë dijeni për të fshehtë. Prandaj, me këtë leksion duam t'i qartësojmë njerëzit se askush tjetër, përveç Allahut të Lartësuar, nuk e di të fshehtë dhe as atë me të cilën Ai ka informuar vetë robërit e Tij.

6-Thërritja e shpirtave të të vdekurve: Është një nga mënyrat që shumë njerëz gjejnë strehë. Kjo ndodh kudo, në të gjitha vendet e botës. Kudo përdoret thërritja e shpirtave të të vdekurve. Për këtë përdoren shumë mënyra. Njëra prej mënyrave është kjo që praktikohet në Liban: sillet një derrasë ose dru, ose një copë letër e trashë dhe në ato shkruajnë ajete të caktuara ose shkronja të alfabetit. Sillet një filxhan dhe vendoset në mes. Një pjesë e njerëzve lexojnë ajete kur'anore dhe thërrasin emrin

⁹ Sure "Sebe'", ajeti 14.

e të vdekurit që të vijë nga bota e Barzakhut dhe të shfaqet në filxhan. Pastaj i drejtojnë pyetje të vdekurit, kurse filxhani rrotullohet rreth shkronjave duke formuar fjalë. Në Liban ka shumë njerëz që kanë humbur kohën e tyre me këtë gjë, kurse në Nexhefin fisnik, kur unë isha atje, pashë se disa studentë ishin të angazhuar me këto tregime dhe unë do t'u them atyre pas pak përgjigjen e martirit, (shhid) Es-Sadr¹⁰.

Ata besojnë se e sjellin shpirtin e të vdekurit aty për ta pyetur për gabimet dhe eksperiencat që kanë bërë. Ose besojnë se e sjellin shpirtin e gjyshit të tyre për t'u treguar thesarin. Një formë tjetër që mbështetet në perëndim, përmes së cilës hipotezojnë se e sjellin shpirtin dhe e fusim atë brenda një personi tjetër prezent dhe ai flet me gjuhën e të vdekurit. Edhe mënyrat e lartpërmendura, edhe kjo mënyrë nuk janë të vërteta dhe nuk janë rrugët e njohjes së dijes së fshehtë.

Vallë, vërtet e lëviz filxhanin diçka? Po, është diçka që e lëviz. Një ditë prej ditësh, shkuam një grup personash tek Sejjid Sadri në Nexhef dhe ai na foli për këtë temë. Ai na tha se ajo që e lëviz filxhanin nuk është shpirti i të vdekurit.

Lëvizja e filxhanit ka mundësi të bëhet nga xhindët. Ai që thotë se Allahu i Madhëruar i ka dhënë autoritet të këtij lloji aq sa ata të afrojnë shpirtat e të vdekurve, ka

¹⁰ Ai është shhidi i nderuari Muhamed Bakri Sadr (Allahu qoftë i kënaqur me të!).

thënë diçka të pallogjikshme. Nuk ka asnjë bazë në shariat. Edhe sikur të supozojmë se ky është shpirti i një të vdekuri, ky i vdekur kur ka qenë në jetë, a e ka ditur të fshehtën? Çfarë i ka lejuar Allahu atij që të dijë? Shpirti i të vdekurit mund të dijë të shkuarën e tij që ai ka përjetuar dhe një pjesë të të fshehtave, por kjo nuk është një mënyrë për të njohur dhe mësuar të fshehtën.

Të gjitha rastet e përmendura janë mendime, iluzione dhe imagjinata. Ata nuk tregojnë të fshehtën. Argumenti është se shumë prej lajmeve të astrologëve, të asrtonomëve, të atyre që shikojnë fatin duke lexuar dorën, të atyre që afrojnë xhindët, të atyre që sjellin shpirtrat dhe të atyre që bëjnë falle me anë të llogarive nuk janë krejtësisht të vërteta. Një pjesë janë të vërteta, kurse pjesa tjetër jo. Pjesa që është e vërtetë nuk e argumenton metodikën e njohjes së të vërtetës. Ne nuk jemi as astrologë dhe as astronomë, as kështu dhe as ashtu, por kur mendojmë dhe analizojmë klimën politike, në çdo rast shohim se ka çështje që janë të vërteta dhe të pavërteta. Mjaftojnë që disa analiza dhe profeci të jenë të pavërteta për të argumentuar se kjo rrugë nuk është e drejtë dhe ato që thuhën për të janë supozime, hamendësime.

ËNDRRAT DHE LIDHJET E TYRE ME TË ARDHMEN

Ka edhe një rrugë tjetër që unë e kritikoj dhe e gjykoj ndryshe. Është rruga që ka të bëjë me ëndrrat. Për shembull, filani ka parë në ëndërr se ka ndodhur një luftë në filan vend, e kështu e ashtu. Sot këto gjëra nuk përbëjnë informacion, sepse teknologjia dixhitale e ka bërë botën kaq të vogël, sa në fare pak kohë, çdo lajm përhapet me shpejtësi. Nuk ka asnjë kuptim të besosh në thëniet e bazuara në ëndërra.

Tema e ëndrrave është një hulumtim i gjatë dhe i thellë, i lidhur ngushtë me shumë fusha, si: me mjekësinë, me psikologjinë, me kontekste kulturore, fetare dhe shkencore të mirëpërcaktuara. Ka shumë sociologë, psikologë, psikiatër etj. që e trajtojnë këtë hulumtim, prandaj ne do ta përmbledhim mendimin në tri çështje kryesore:

Së pari: nuk ka asnjë dyshim se njerëzit shikojnë ëndrra dhe kjo gjë nuk ka nevojë për ndonjë argument.

Së dyti: këto ëndrra, në të gjitha rastet mbeten ëndërra...

Së treti: ekziston një lloj ëndrre që është vegim i vërtetë, por unë nuk flas këtu për vegimin e pejgamberëve, sepse kjo lloj ëndrre e tyre është njëra pjesë e shpalljes, e

komunikimit dhe inspirimit të peygamberëve të Allahut. Kështu, peygamberi Jusuf (Paqja qoftë mbi të!) tregohet se pa në ëndërr diellin dhe hënën. Ky është inspirim. Peygamberi Muhamed, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) pa në ëndërr çlirimin e Mekës. Dhe ky është inspirim.

Vegimi i vërtetë "ru'ja" nuk është një kusht për besimtarin, për të devotshmin, për besnikun dhe mikun e miqve të Allahut të Madhëruar. Përkundrazi, çdo person mund të shikojë një vegim të vërtetë. Për këtë na ka lajmëruar Kur'ani, siç është rasti për mbretin e Egjiptit, kur ai thotë: **Dhe tha mbreti: "Kam parë në ëndërr shtatë lopë të majme, të cilat po i hanin shtatë lopë të dobëta dhe kam parë shtatë kallinj të gjelbër e shtatë të tjerë të tharë. O para ime, më shpjegoni ëndrrën time, nëse dini t'i interpretoni ëndrrat!"**¹¹

Gjithashtu thotë: **"O shokët e mi të burgut! Njëri prej jush do t'i shërbejë verë pronarit të vet, kurse tjetri do të kryqëzohet e shpendët do të hanë prej kokës së tij. Kështu është caktuar kjo gjë për të cilën pyetët ju!"**¹²

Kjo është një ëndërr e vërtetë. Po, ka ëndrra të kota, pa pikë kuptimi, por ka edhe ëndrra, vegime të vërteta. Mirëpo ne nuk mund të mbështesim temën e ëndrrave si vegime të vërteta, as si ëndrra pa kuptim. Ëndrrat e peygamberëve përbëjnë një çështje më vete që kërkon një

¹¹ Sure "Jusuf", ajeti 43.

¹² Sure "Jusuf", ajeti 41.

studim tjetër. Edhe sikur të arrijmë të themi se kjo ëndërr është e vërtetë, cili do ta interpretonte atë? Për shembull, cili e komentoi ëndërrën e Faraonit? Ajo kishte nevojë për një peygamber. Po ëndërrën e shokëve të burgut cili do ta interpretonte? Edhe kjo kishte nevojë për një peygamber.

A JANË ËNDRRAT PROVË, ARGUMENT?

Ne e kemi të qartë se ëndrrat nuk janë një argument në aspektin ligjor sheriatik. Askush nuk mund të thotë se unë do të veproj kështu, sepse e kam parë në ëndërr, se dua të lë tregtinë, se dua të ndaj gruan time, se në vijën e frontit dikush kishte një fuqi rraketore dhe nisi të lëshojë rraketa, vetëm pse ai i ka parë në ëndërr. Vërtet, ëndrrat kanë efekte psikologjike përgëzuese dhe qetësuese, por a janë ëndrrat një mënyrë e besueshme shkencore në të cilën mund të mbështetesh? Përgjigjia është: nuk mund të mbështetemi dhe as të bazohemi në ëndrra!

PËRSE ALLAHU I MADHËRUAR E KA MBYLLUR DERËN E DIJES SË FSHEHTË?

Allahu i Lartësuar me urtësinë dhe bujarinë e Tij ka krijuar shumë mundësi që njeriu të hapë shumë dyer të dijes dhe të njohurive, saqë ai sot ka bërë një hap gjigand në shkencën e teknologjisë, të komunikacionit dhe kërkimeve shkencore dhe filozofike. Por Allahu i Madhëruar derën e dijes së fshehtë e ka mbyllur. Po përse?!

Allahu është Ai që na i ka dhënë të gjitha mundësitë, na i ka hapur të gjitha dyert e dijes dhe të shkencës, por ka mbyllur derën e dijes së fshehtë. E ka mbyllur derën e dijes së fshehtë, sepse ka një urtësi në të. Allahu i Madhëruar nuk është koprac! Si mund të jetë e mundur kjo, kur Ai është më i Miri i të mirëve!

Allahu i Lartësuar na e ka mbyllur ne këtë derë nga mëshira e madhe që ka për ne! Në qoftë se vjen dikush prej nesh, të cilit Allahu i Madhëruar i ka dhuruar dijen e fshehtë dhe mëson se babai i tij do të vdesë në filan ditë, se nëna e vet do të sëmuret në filan ditë, se gruaja, fëmija dhe vetë do të përjetojnë këtë apo atë gjë në filan ditë, si do të ishte jeta e këtij njeriu pas kësaj dije? Në qoftë se Allahu i Madhëruar i mëson njeriut dijen e vdekjeve të njerëzve të tij të dashur, si do ta gjente ai kënaqësinë e jetës?

Në qoftë se e dijmë se i afërmi i një personi do të vdesë pas tri ditësh, a mund ta përballojmë këtë kur ta shikojmë atë? Po, si ta suportojmë këtë dije?

Edhe te pejgamberët, nivelet e durimit, të fuqive dhe të aftësive të tyre për të duruar kanë qenë të ndryshëm. Allahu i Madhëruar është shumë i Mëshirshëm me ne dhe për ne Ai gjithnjë ka dashur një jetë të mirë. Është kjo arsyeja që na e ka mbyllur derën e dijes së fshehtë. Allahu i Madhëruar, gjithashtu, ka dashur që ne të bëjmë ç'është e mundur, të përpiqemi, të luftojmë, të mësojmë dhe t'i mësojmë edhe të tjerët, të durojnë dhe suportojnë, sepse kjo dynja është bota e sprovave dhe vepër e plotësimeve të Tij, është promovimi i sprovimit dhe i testimi të Tij. Sikur ne të dinim çdo gjë, do të shkatërrohej jeta. Allahu i Madhëruar gjithçka e ka ndërtuar me urtësi.

Prandaj, Allahu i Madhëruar ua ka treguar një pjesë të dijes së fshehtë disa pejgamberëve të Tij. U ka treguar aq sa i duhet njeriut për të ndërtuar jetën e tij, për të përqafuar fenë dhe të ardhmen e tyre si për ngushëllimet e tyre fetare në këtë botë dhe në Botën Tjetër. Prandaj urtësia dhe mëshira e Allahut nuk na e ka hapur derën e dijes së fshehtë.

SI TI MËSOJMË LAJMET E SË ARDHMES?

Pjesa e dytë e leksionit na tregon se rruga e vetme për të mësuar lajmet e së ardhmes është burim hyjnor. Por si të arrijmë tek burimi hyjnor që emeton këto lajme?! Në qoftë se arrijmë tek burimi hyjnor i lajmit si ta trajtojmë atë? Ky leksion do të trajtojë temën e shenjave të fundit dhe kohës së fundit në këtë linjë.

Falënderimi i takon Zotit të botëve!

HULUMTIMI I DYTË

PIKËPAMJA E ISLAMIT PËR LAJMET E DIJES SË FSHEHTË DHE TË ARDHMEN.¹³

KUR'ANI DHE TRADITA PROFETIKE JANË DY BURIME TË RËNDËSISHME TË DIJES SË FSHEHTË

Në leksionin e kaluar treguam se njerëzit, sot dhe në të shkuarën kanë patur një interesim të madh për lajmet e së ardhmes.

Midis të tjerash theksuam se lajmërimet e Allahut të Madhëruar janë dije e fshehtë. Atë nuk e di askush, përveç Allahut të Madhëruar. Allahu i Madhëruar ua ka fshehur këtë njerëzve, por u ka hapur atyre dyer të tjera të dijes. Ua ka fshehur këtë lloj dijeje si mëshirë për ta, me qëllim që jeta të ecë normalisht në rrugë të drejtë. Allahu i

¹³ Fjala e eminencës së tij i nderuari Hasan Nasrullah (Zoti e ruajtë!) në këshillin e ashurasë, nata e pestë e munajit Muharrem i vitit 1436 h - 31/10/2014.

Madhëruar një pjesë të robërve të Tij ua mëson dijen e fshehtë për një urtësi dhe qëllim. Nga urtësia ne mësuam se rruga e vetme që të çon tek lajmet e së ardhmes është kur lajmi i referohet të Gjithëditurit të dijes së fshehtë dhe Ai është Allahu i Madhëruar! Rruga më e rëndësishme për ta marrë lajmin nëpërmjet kësaj mënyre është shpallja. Ne muslimanët kemi dy burime shumë të rëndësishme në lidhje me këtë. Burimi i parë është Kur'ani Fisnik. Burimi i dytë janë hadithet dhe transmetimet që kanë ardhur deri tek ne.

Sa i përket burimit të parë, Kur'anit Fisnik, ne muslimanët, jemi të gjithë në një mendje. Çdo çdo gjë që ka në të, ka ardhur me të vërtetë nga Allahu i Madhëruar! Për këtë përdoret thënia: “Pa dyshim ai e ka burimin e padiskutueshëm” Do me thënë ka buruar në mënyrë kategorike prej Allahut të Lartësuar. Për të nuk ka asnjë dyshim, asnjë iluzion dhe asnjë debat! Çdo gjë që është brenda atyre dy kapakëve është fjala e Allahut! Këtu mbetet një detyrë. Ajetet janë prej Allahut të Madhëruar, por kuptimi ynë i domethëniesve të ajeteve dhe argumenteve të tyre duhet të jetë tejet i sigurtë dhe i qartë.

KUR'ANI FISNIK DHE LAJMET QË PËRCJELL PËR TË ARDHMEN

Në Kur'anin Fisnik ka shumë lajme të dijes së fshehtë edhe për të ardhmen. Pjesa më e madhe e Kur'anit trajton domethënien e dijes së fshehtë, gajbin, si kuptim të gjerë. Kurse lajmet për të ardhmen, për tokën dhe ngjarjet, Kur'ani i ka paraqitur në shumë vende. Lajmet e së ardhmes që ka lajmëruar Kur'ani kanë pasur lidhje me ngjarjet e kohës së fundit, por edhe me ngjarjet e afërta, kanë patur lidhje me kohën e të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Shembulli i kësaj urtësie është sureja “Rrum”. Kur Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) ka qenë në Mekë, besimtarët kanë qenë të pakët në numër, kurse idhujtarët ishin të shumtë. Në atë kohë ndodh një luftë midis persëve dhe romakëve, mes dy mbretërive më të mëdha të kohës. Persët kanë qenë zjarradhurues, kurse romakët kristianë. Zjarradhuruesit i mposhtën romakët kristianë dhe kjo i gëzoi shumë idhujtarët e Mekës. Idhujtarët e Mekës këtë ngjarje e morën si një ogur të mirë dhe kujtuan se edhe ata do të triumfonin ndaj Muhamedit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Por erdhi sureja që të japë lajmin: “**Elif, Lam, Mim. Bizantët** (rumët)

u mundën, në tokën më të ulët më afër (tokës së arabëve), por pas disfatës së tyre ata do të ngadhënjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë ditë (kur do të fitojnë bizantët), besimtarët do të gëzohen, për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i Plotfuqishëm, Mëshirues i madh!"¹⁴

Ky lajmërim ka për qëllim të vlerësojë besimin te i Dërguari i Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për atë që thotë për shpalljen e cila i është zbritur atij, si dhe për të forcuar besimin e muslimanëve dhe të të tjerëve. Ky lajmërim në atë kohë kishte qëllime të mira dhe urtësi.

Në një vend tjetër, numri i idhujtarëve ishte shumë i madh, kurse muslimanët vetëm pak fare. Idhujtarët u thonin gjithmonë muslimanëve se do t'ju mposhtim. Në dukje tema është logjike, sepse ndërmjet dy grupeve që përgatiten për luftë mes tyre nuk krahasohet ana materiale, as numri, as fuqitë potenciale dhe asnjë gjë tjetër. Allahu i Madhëruar në një ajet për gjendjen në Mekë ka përcjellë një sfidë: **"A mos po thonë: 'Ne jemi një grup ngadhënjes tok të bashkuar?' Grupi do të pësojë disfatë dhe ata do të kthehen prapa."**¹⁵ Allahu i Madhëruar u premtoi besimtarëve se së afërmi do të kenë një triumf dhe i lajmëroi për këtë.

¹⁴ Sure "Rrum", ajetet 1-5.

¹⁵ Sure "Kamer", ajetet 44 - 45.

Dëshmia e tretë dhe e fundit është ajo që përmendet në suren "Fet'h": "**Allahu ëndrrën e të Dërguarit të Vet e vërtetoi me realitet se me vullnetin e Allahut do të hyni në Xhaminë e Shenjtë (në Qabe) të siguruar, t'i rruani flokët e kokave tuaja, t'i shkurtoni e nuk do të keni frikë! Pra, Ai ka ditur atë që ju nuk e dinit, para kësaj ju dha një fitore të shpejtë (Hajberin).**"¹⁶

Kjo ngjarje ndodhi më vonë. Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe muslimanët u futën në Mekë me kokat e tyre të rruara.

¹⁶ Sure "Fet'h", ajeti 27.

E ARDHMJA E NJERËZVE PUNËMIRË

Për lajmet e së ardhmes flasin shumë ajete. Për temën tonë do të marrim tre ajete për komentim.

Në ajetin e parë Allahu i Madhëruar thotë: **“E Ne duam t’i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t’i bëjmë udhëheqës dhe t’i bëjmë trashëgues.”**¹⁷

Allahu i Madhëruar thotë se Ai do t’i lartësojë ata që u shtypën në tokë dhe do t’i përzgjedhë ata duke i bërë udhëheqës të tokës dhe drejtues. Ata do ta trashëgojnë atë tokë përballë të gjitha qeverive dhe udhëheqësve.

Ajeti i dytë thotë: **“Atyre nga mesi juaj që besuan dhe bënë vepra të mira, Allahu u premtoi se do t’i bëjë trashëgimtarë në atë tokë, ashtu si pat bërë trashëgimtarë ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta, do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’ju dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.”**¹⁸

Ky ajet flet për premtimin e Allahut që u bën besimtarëve punëmirë. Allahu i Madhëruar do t’i bëjë ata trashëgimtarë të tokës dhe do t’i bëjë të jenë udhëheqës

¹⁷ Sure "Kasas", ajeti 5.

¹⁸ Sure "Nur", ajeti 55.

dhe se do të marrin garanci, siguri dhe paqe pa pasur fare frikë.

Ajeti i tretë: **“Ne e kemi shënuar në Zebur, (në librat e shenjtë) pas shënimit (në Lehvi Mahfudh), se me të vërtetë tokën do ta trashëgojnë robërit e Mi të mirë.”**¹⁹.

Është shkruar në Zebur se e ardhmja e tokës është e ardhmja e njerëzve punëmirë, e shoqërisë dhe qeverisjes së punëmirëve. Këto janë tekste kur'anore të qarta. Edhe ajetet e tij janë me kuptime shumë të qarta. Përmbledhja e tyre thekson se e ardhmja e njerëzimit dhe e ardhmja e tokës do t'u kthehet njerëzve të shtypur dhe muslimanëve. Qeveria e njerëzve të shtypur do të jetë qeveria që do të ekzistojë në fundin e kohës, para se të bëhet Kijameti.

¹⁹ Sure "Enbija", ajeti 105.

UDHËHEQJA HYJNORE DHE E ARDHMJA E TË MIRËVE

Këtë mesazh e përcjellin dhe e argumentojnë shumë ajete. Ajeti i parë ka përmendur dëshirën e Allahut, "nuriidu". Ajeti i dytë thekson premtimin "va'dun", kurse ajeti i tretë shënimin "mektub".

Kur'ani Kerim nuk ka treguar ndonjë detaj se mbi çfarë do të formohet kjo qeverisje botërore në fundin e kohës, por për këtë çështje ka folur Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Komentuesit e Kur'anit, kur arrijnë tek këto ajete, citojnë transmetime për të na qartësuar më shumë se ky premtim, në fundin e kohës, do të jetë në një dorë të madhe, pikërisht në dorën e Mehdiut, (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), me të cilin Allahu do ta mbushë tokën me drejtësi, pas gjithë padrejtësive dhe mizorive.²⁰ Ai është prej djemve të të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), prej djemve të Fatimes, (Paqja qoftë mbi ta!). Kjo përmbajtje mbart brenda saj transmetime të shumta tek shiitët dhe synitët.


²⁰ Lexo: Shejkh Sadukun, Muhamed bin Ali bin Babevij el-Kummi, Kemaluddin dhe Temamu ni'mete, Arritje, "Tahkik ve tas'hih ue ta'lik": Ali Ekber el-Gafarij, botimi: Muharrem el-haram 1405-1363, botuar dhe publikuar nga fondacioni i përhapjes islame ndjekëse e xhematit të mësuesve të Kunit sherifit, faqe 258.

Po kështu, ne muslimanët besojmë edhe rikthimin në tokë të të nderuarit Mesiut (Paqja qoftë mbi të!) dhe më pas, nën përgjegjësinë e Mehdiut dhe Mesiut (Paqja qoftë mbi ta!), do të realizohet trashëgimia e besimtarëve punëmirë, të cilët janë shtypur në këtë botë dhe mbi tokë do të ngrihet shteti i paqes, i drejtësisë dhe i mirëqënies. Çdo gjë që njerëzimi ka mësuar që prej zanafillës së krijimit do të realizohet së shpejti, në dashtë Allahu. Kjo do të jetë e mundur vetëm nëpërmjet rikthimit tek burimi kur'anor.

LAJMET E SË ARDHMES NË TRANSMETIME

Burimi i dytë trajton hadithet që kanë trasmetuar muslimanët që nga Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ky burim trajton edhe lajmet e së ardhmes, të dijes së fshehtë dhe lajmet e kohës që kanë përmendur Ehli Bejti. Për këtë temë ka qindra hadithe dhe transmetime. Një pjesë e dijetarëve kanë thënë se janë mijëra transmetime që flasin për të ardhmen dhe fundin e kohës. Tekstet e këtyre transmetimeve gjenden në librin "*El-Melahimu vel fitenu*". Kohët e fundit një pjesë e dijetarëve janë marrë me tubimin e të gjitha transmetimeve që kanë lidhje në mënyra të ndryshme me Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

Ne na është folur për të ardhmen nga një numër i madh transmetimesh prej Pejgamberit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Me termin "e ardhmja" në këtë kontekst kuptohet koha pas Pejgamberit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe lajmet e së ardhmes lidhen me ato që do të ndodhin në atë periudhë kohe. Metodologjikisht hadithet dhe transmetimet mund të ndahen në shumë pjesë, por ne do t'i klasifikojmë në tri ndarje, të cilat kanë lidhje me rezultatin e hulumtimit.



NDARJA E TRANSMETIMEVE LIDHUR ME TË ARDHMEN

Në pjesën e parë grupohen lajmet e së ardhmes dhe dijet e fshehta që nuk janë të lidhura me Imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe shtetin e kohës së fundit. Këto transmetime përcjellin mesazhin se në të ardhmen do të ndodhë kjo apo ajo gjë, si p.sh.: “Do të vijë një kohë që njerëzit...”, ose “... për ymetin tim do të vijë një kohë kështu e ashtu...”²¹ Por shumica e tyre nuk janë të lidhura me kontekstin e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

P.sh., Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka lajmëruar se çfarë do ndodhë pas vdekjes së tij. Thuhet se ai ka thënë se do të vijë një kohë që do të qeverisin beni Umejet. Kjo gjendet në transmetimet për padrejtësinë, mizorinë e gjykatësve ekzekutivë të Beni Umejeve. Flitet për flamujt që do ta shfarosin qeverisjen e beni Umejeve, për shkatërrimin e beni Abasëve, për situatat e beni Abasëve dhe për zvarritjen e mongolëve, për rrethanat e botës, për luftërat, për drejtuesit e shteteve dhe princat, për dijetarët dhe

²¹ Lexo: Shejkh Kulejni, Muhamed bin Jakubin, el-Kafi, Tas-hih ue ta'lik: Ali Ekber Gafari, botimi: i katërt, 1365 shtëpia botuese el-Hajderij, botoi shtëpia e librave islamë - Taheran, vëll 2, faqe 91 dhe 296; vëll 8, faqe 308.

lexuesit e Kur'anit, për gratë dhe burrat, për lidhjet shoqërore, për lidhjen e fëmijës me familjen e tij, për ngjarjet e universit, si: lindja e Diellit nga perendimi, eklipsët diellore dhe hënore, shirat dhe tërmetet etj. Të gjitha këto transmetime tregojnë këtë lloj të lajmeve, lajmet e së ardhmes.

Në pjesën e dytë të librit “El Irshad” i shejkh Mufidit²² janë grupuar transmetimet ku flitet për veshjet, për librat, për xhamitë dhe për Kur'anin. Në këto transmetime ka shumë detaje, të cilat janë prezente në librat e shiitëve, të synitëve dhe në shumë prej këtyre lajmërimeve. Ne sot jemi në vitin 1436 h. Nëse e shikojmë se çfarë ka ndodhur në botë që para këtij viti edhe pas këtij viti, do të bindemi se shumë prej transmetimeve dhe haditheve janë vërtetuar.

Pjesa e dytë trajton shenjat dhe hadithet që lidhen me drejtpërsëdrejti me Imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) ose kanë pasur një lloj lidhje me të. Këto hadithe nuk thonë që në se vërtetohet ky lajm, nuk ka dyshim se mes tij dhe Mehdiut ka një lidhje kohore. Hadithet e kanë lënë temën të hapur përsa i përket ndodhive në kohë. Një pjesë e tyre mund të jenë ngjarje që kanë ndodhur në të shkuarën ose me shekuj larg

²² Lexo: el-Mufidu, Muhamed bin Muhamed; el-irshadu fi ma'rifeti huxhexhil-lah ael el ibad, Tahkik ue tas-hih: fondacioni Alul Bejti, publikoi: Konferenca e Shejh Mufidit, vendi i botimit: Kum, data e botimit 1413 h, botimi: i parë, vëll 2, faqe. 368.

ngritjes së Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), Allahu e di më mirë.

Për shembull, thuhet: “Nuk do të bëhet kjo gjë para se të bëhet kjo dhe kjo...”, “...nuk do të shikoni atë që doni më shumë, para se të bëhet kështu e ashtu...”²³ Thuhet se këto ngjarje e fakte lidhen plotësisht me Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe se do të ndodhin para daljes së tij, por pa përcaktuar kufij kohorë.

Nuk do të konsiderohej pengesë në se do të përmenden një pjesë e lajmërimeve të pjesës së parë dhe të pjesës së dytë. P.sh., lindja e shtetit të beni Abasit dhe shkatërrimi i tyre që u përmend në pjesën e parë, mirëpo hapësira kohore midis shtetit beni Abasit dhe shfaqjes së Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), është e panjohur.

Pjesa e tretë, trajton ngjarjet që janë të lidhura me kohën. Në transmetime ka thënie që lidhen me kohën, ka përcaktime kohore dhe ka ngjarje që lidhen me daljen e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Për shembull: “...në muajin Ramazan apo në një vit kohor...”, do me thënë është përmendur një përcaktim kohor.

Ky është lloji i shenjave, të cilat janë të lidhura me Imamin sipas kohës. Këto shenja do t’i quajmë “Shenajt e veçanta”. Këto transmetime ekzistojnë tek shiitët dhe

²³ Lexo: Ibn Ebi Zejneb Nu‘mani, el-Gejbetu, Tahkik: Faris Hassun Kerim, botimi i parë, viti i botimit 1422, shtëpia botuese Mahr - Kum, publikoi Envarul Huda, faqe 33.

synitët. P.sh. dalja e Sufjaniut, Horasaniut dhe e Jemeniut.²⁴ Shenja këtu është dalja dhe ka mundësi që personi të jetë prezent, sepse fjala e përdorur është “dalja”, (el-khuruxhu) dhe nuk nënkupton personin që është në dynja.

Një prej ngjarjeve të lidhura ngushtë me kohën është gjithashtu, edhe vrasja e njeriut të pastër në Qabe (midis cepit ku fillon tavafi dhe mekemit, vendqëndrimin të Ibrahimit). Disa transmetime thonë: “Ai që vritet është një i ri i fisit të mirë të Hashimit dhe është djalë, kurse britma vjen nga qielli.” Transmetimet përmendin se Xhebraili thërret në qiell dhe jep lajmin për Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), e emërton atë dhe fton për të dhënë ndihmën e tij. Ai u flet të gjithë njerëzve me gjuhën e tyre. Ky zë, në një çast të vetëm dëgjohej në të gjithë botën nga i gjithë njerëzimi. Ky është një zë i fortë dhe i ashpër. Disa transmetime tregojnë për dridhërimën që i godet njerëzit kur e dëgjojnë atë zë. Një tjetër ngjarje e ndërlidhur është shfaqja e Imamit një ditë apo një javë pas britmës. Disa transmetime thonë se shfaqet po atë ditë.

Një ngjarje tjetër është fundosja në shkretëtirë, e cila tregon se kur Sufjaniu del, dërgon një ushtri në Hixhaz dhe

²⁴ Lexo Shejh Sadukun, ibn Babeuej, Muhamed bin Ali, el-Khisal, Tahkikun ue tashihu, Ali ekber Gafari, botuesi: Xhemaetul muder-risin, Kum, data e botimit: 1403 h. Botimi i parë; vëll 1, faq 303. Është transmetuar nga Imam Sadiku se ka thënë: “*Pesë gjëra do ndodhin para Kijametit, dalja e Jemeniut, e Sufjaniut dhe thirrësit që thërret nga qielli, fundosja në shkretëtirë dhe vrasja e njeriut të pafajshëm*”.

një ushtri në Irak. Ushtria që dërgon në Hixhaz, bën në Medine ato veprime që kishin bërë gjyshërit dhe baballarët e tij, (Jezidi dhe Muavija). Kjo ushtri fundoset në rërë në fillim të rrugës midis Medines, Mekës dhe Jubadit. Prej kësaj ushtrie mbeten vetëm dy njerëz. Kjo është treguar tek ehli syneti dhe shiitët.

Këto lloj ngjarjesh quhen ngjarje sinkronike dhe flasin për një rreth të ngushtë kohor, për një vit kohor, disa muaj ose ditë. Disa transmetime e kanë përngjasur çështjen si peri i tespive, ku rruaza ndjek rruazën²⁵. Ashtu edhe këto ngjarje janë të lidhura dhe ndjekin njëra-tjetrën, prandaj këto shenja quhen shenja të veçanta.

Pra, në ndarjen e parë transmetimet tregonin për lajmet e përgjithshme të së ardhmes. Në ndarjen e dytë transmetimet tregonin për Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), për afatet e caktuara dhe të pacaktuara kohore. Në ndarjen e tretë flitet për Imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), i cili ka një lidhje kohore të përcaktuar.

Sot, një pjesë të këtyre shenjave dhe lajmërimeve i trajtojnë në mënyrë korrekte kurse një pjesë tjetër i trajtojnë në një mënyrë të gabuar, por duhet patur parasysh se edhe përfitimet varen nga mënyra e vlerësimit përkatës.

²⁵ Lexo: Ibn Ebi Zejneb, Muhamed bin Ibrahim, el-Gejbetu, Tahkiku Ali ekber Gafariu, botuesi: Shtëpia botuese Saduk, Teheran, data e botimit: 1397, botimi: i pari 255 faqe dhe në të ka: "Dalja e Sufjaniut, Jemeniut dhe Horasaniut brenda një viti, në një muaj, në një ditë, një rregull si rregulli i tespive".

DOBIA E MËSIMIT TË LAJMEVE TË SË ARDHMES

Të njohësh, apo të mësosh ato që do të ndodhin në të ardhmen, sjell dobi të njëjtë me ato që lidhen me Imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

Një pjesë thonë se nuk ka asnjë dobi. A është njësoj edhe nëse e dimë, edhe nëse nuk e dimë? Nëse ato janë të vërteta, do të realizohen dhe, kur të realizohen, do t'i mësojmë. Prandaj është më mirë që të dijmë, që të mësojmë dhe të asimilojmë informacione që kanë dobi dhe të mira.

DOBI IDEOLOGJIKE

A i ka vënë në Kur'an Allahu i Lartësuar lajmet për të ardhmen së bashku me ajetet si shtesë, apo i ka vënë sepse në to ka një mençuri? Në çdo dije të fshehtë, të cilën ua ka përcjellë peygamberëve të Tij, Allahu i Lartësuar ka vënë një urtësi dhe një mëshirë. Po Peygamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), kur ka lajmëruar të gjitha këto detaje të cilat shoqërojnë ngjarjet nëpërmjet transmetimeve, a i ka lajmëruar muslimanët për ndonjë urtësi, mëshirë apo ndonjë qëllim? Është e sigurtë dhe e konfirmuar se të gjitha transmetimet që njoftojnë për ngjarjet kanë qëllime dhe urtësi. Allahu i Lartësuar i ka lajmëruar të dërguarit dhe peygamberët e Tij për këto mirësi dhe dobi. Edhe nëse nuk e kemi zbuluar urtësinë apo dobinë që rrjedh prej tyre, është mëse e sigurtë se ato përcjellin urtësi dhe mëshirë.

VËRTETIMI I PROFETËVE

Në bazë të kriterit ideologjik, vërtetësia e këtyre haditheve ka një dobi të madhe. Pejgamberëve, (Paqja qoftë mbi ta!) gjithmonë kur vinin tek popujt e tyre, u kërkohesh një argument dhe argumenti ishte mrekullia. Kurse Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka pasur një ose shumë mrekulli me qëllim që secili person të fillojë të pretendojë profecinë, mesazhin dhe lidhjen me të fshehtë.

Prej shumë mrekullive të pejgamberëve të mëparshëm, (Paqja qoftë mbi ta!), është shembulli i Musait dhe i Isat, (Paqja qoftë mbi ata të dy!). Ky ka qenë lajmërimi për të ardhmen dhe se do të ndodhë kështu apo ashtu. Pejgamberi Isa, (Paqja qoftë mbi të!) thuhet se i ka pas lajmëruar njerëzit për të fshehtë dhe se çfarë kishin në shtëpitë e tyre, kurse të gjitha ato që ka thënë Pejgamberi ynë, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), sipas transmetimeve të konfirmuara janë vërtetuar dhe realizuar. A nuk është ky një argument për vërtetësinë dhe sinqeritetin e këtij Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)? A nuk tregon edhe madhështinë e këtij Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij)? A nuk tregon diturinë e thellë të këtij Pejgamberi,

(Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), fakti që ai na thotë se si ka qenë dhe si do të jetë jata njerëzore deri në Ditën e Kijametit?! Ne që e besojmë profecinë e pejgamberit Muhamed, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) na shtohet besimi për profecinë dhe fisnikërinë e Pejgamberit tonë. Dhe kjo ka dobi të madhe!

Kur një person na lajmëron për një, për dy, apo për qindra çështje të vërteta, na shton besimin dhe bindjen në forcat tona, edhe sikur të mos flasë për dijen e fshehtë. Po në qoftë se ai person ka qenë një pejgamber që na lajmëronte për shpalljen, na lajmëronte se do të ndodhë kështu apo ashtu për një periudhë kohore qindra vjeçare e deri kur të bëhet Kijameti? Po nëse ai vazhdon të flasë për të fshehtat, shumica e të cilave janë vërtetuar? Po nëse ai na flet për ngjarje që do të ndodhin në të ardhmen? Të gjitha këto kanë dobi se i përkasin dijes. Por, në qoftë se ne e neglizhojmë këtë informacion dhe e mbajmë në libra, nuk do të përfitojmë prej tij.

DOBI PSIKOLOGJIKE

Kjo është një çështje e rëndësishme dhe është shpresa për të ardhmen. Sot presioni psikologjik është më i madh se kurdoherë më parë. Në kohët e shkuara ngjarjet që kanë ndodhur në lindje nuk i kanë ditur popujt e perëndimit. Edhe atë që ndodhte në Iran nuk e dinte populli afrikan, sepse komunikimi është shumë i ngadaltë. Prandaj secili njihte vetëm problemet e vendit të vet.

Ndërsa sot, si rezultat i zhvillimit të madh të teknodixhitalizimit shohim dhe dëgjojmë çdo gjë. Sigurisht që edhe impresionimi psikologjik është më i madh. Të gjitha ngjarjet janë të lidhura me njëra-tjetrën, kurse në të kaluarën nuk ka pasur plane e projekte të standartit të sotëm që drejtojnë të gjithë lëmshin e tokës. Sot situata ka ndryshuar. Sot kudo dëgjon për konflikt shtetëror, krahinor, katastrofa, sëmundje dhe sfida të çdo niveli: ideologjik, ushtarak, ambjental, kulturor etj. Shtimi i madh i popullsisë dhe mungesa e shpresës çojnë drejt disfatizmit.

E vetmja shpresë për shpëtim është shpresa tek Allahu i Madhëruar. Është shpresa se do të vijë një kohë që besimtarët e drejtë e të shtypur do të qeverisin dhe do të instalojnë paqen, mirëqënien botërore, do të hapin dyert e diturisë që askush nuk i ka hapur më parë.

Njeriu do ta përmbushë këtë shpresë dhe do të tërhiqet drejt saj. Kjo krijon tek ai vendosmërinë, dëshirën dhe këmbënguljen për të punuar, vepruar dhe për t'u përgatitur për këtë shpresë.

NJË DOBI PARAPËRGATITORE PËR TË ARDHMEN

Kolapsi i mizorëve dhe i mendjemëdhenjve dhe formimi i qeverisë së besimtarëve punëmirë që janë shtypur në tokë, është një ngjarje historike botërore e pa precedent. Ajo nuk ndodh as në një çast dhe as rastësisht. Duhet plotësuar disa kushte që të arrihet deri tek ajo. Duhet plotësuar disa kushte edhe në nivelin intelektual dhe mendor, sepse njerëzimi e ka të nevojshme që të përgatitet për ngjarje botërore të këtyre përmasave. Nuk do të bëhet realitet fare papritur ëndrra e peygamberëve në fundin e kohës. Diktatorët e mizorët nuk bien vetë nga froni dhe shteti i së drejtës të jetë ngritur vetiu! Janë njerëzit ato që do t'i realizojnë këto ngryshime, që do të ngrënë shtetin e drejtësisë hyjnore!

Kjo përmbysje ka nevojë për shenja dhe puna jonë është përgatitja psikologjike dhe kulturore për të qënë të gatshëm. Le të sjellim shembullin e Musait, (Paqja qoftë mbi të!). Profecia e tij ishte diçka e pritshme. Beni israilët e kanë pritur atë për qindra vite. Ata janë torturuar, janë skllavëruar prej faraonëve, por kishin një shpresë, sepse i patën lajmëruar peygamberët beni israilitë se do të vinte një Profet i madh që do t'i çlironte nga faraoni dhe padrejtësia e tij. Për këtë ka pasur shenja të kohës: shenjë ishte dalja e

Musait, (Paqja qoftë mbi të!). Këto shenja beni israilët i njihnin, por Faraoni dhe ndihmësit e tij i mësuan këto shenja dhe nisën të therrin atë vit të gjithë fëmijët që lindnin, që të mos rritej Musai (Paqja qoftë mbi të!).

Musain (Paqja qoftë mbi të!) e priste me padurim populli i tij, sepse ai do t'i shpëtonte nga Faraoni. Populli nuk e priste duke e kaluar kohën kot. Ka patur shenja që tregojnë se ata kanë punuar për ta pritur atë.

Gjithashtu edhe Mesiun (Paqja qoftë mbi të!) e kanë pritur të gjithë çifutët. Kur ai lindi prej Merjemes, (Paqja qoftë mbi të!) ata e akuzuan atë duke i thënë se vepra e saj ishte një gjynah i madh, ndërkohë që e dinin shumë mirë se ishin duke pritur të nderuarin Mesiun (Paqja qoftë mbi të!) prej qindra vitesh. Pejgamberët që kishin ardhur më parë përgëzuan ardhjen e tij dhe flisnin gjithnjë për të, kurse shenjat e kohës që ai do shfaqej ishin të përhapura kudo.

Edhe Pejgamberi ynë, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) është prezent në librat e çifutëve. Këtë ata e dinë mirë. Ata e vëzhgonin lindjen e tij dhe lajmëronin arabët se këtu do të lindë Pejgamberi i kohës së fundit. Kjo gjë ka qenë e ditur edhe te kristianët. Kjo ka qenë e njohur edhe në Iran. Madje Selman Farisiu erdhi nga Irani për të arritur tek i Dërguari, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!).

Një ngjarje të tilla, siç janë dalja e Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe rikthimi i të nderuarit Isa

(Paqja qoftë mbi të!) në tokë nuk ndodhin befas, pa parapërgatitje, pa përgatitje psikologjike, shpirtërore, kulturore, ideologjike, territoriale dhe njerëzore, serioze dhe reale. Nuk kërkohet që Mesiu (paqja qoftë mbi të!) të rikthehet në dynja që çifutët t'i bëjnë përsëri kurthe. As nuk kërkohet që të dalë Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) që njerëzit të tallen me të, siç poshtëruan gjyshin e tij, Imam Hyseinin (Paqja qoftë mi të!) për t'u bërë një Qerbela e re dhe një sakrificë e re. Ajo që pritet është që të jenë ndihmëtarë dhe adhurues besimtarë, që të trashëgojnë tokën kur Allahu i Madhëruar t'u japë leje eulijave të Tij që të lëvizin dhe të dalin. Çështja nuk kufizohet vetëm tek këto dobi dhe interesa. Këtë çështje do ta trajtojmë më gjërë herë tjetër, sepse tani koha nuk na premtton për më tepër se kaq.

AFRIMI I SHPRESËS

Në udhë të gjata është rregull që të vihen tabela të cilat tregojnë kilometrat. Sa më shumë kilometra kalojmë, aq më shumë na shtohet shpresa se po i afrohem fundit të asaj rruge.

Kështu është edhe me shenjat, të cilat shfaqen dhe na ushqejnë shpresën se ajo që është premtuar po afron. Po të mos ishin këto shenja shpresa jonë do të venitej. Ajetet kur'anore janë shenjat që flasin për të ardhmen, janë argumentimi i afrimit të Ditës së Kijametit.

Ndërkohë ne kemi shenja dhe paralajmërime rreth atyre që do të ndodhin. Konteksti duhet interpretuar kështu: Në qoftë se është thënë se ka qindra gjëra që do të vërtetohen dhe prej tyre janë vërtetuar njëzet, atëherë pa dyshim që do të shpresohet edhe në realizimin e të tjerave. Prandaj, nuk ka asnjë dyshim, se lidhja me të ardhmen është e vërtetë dhe serioze.

SHENJAT JANË UDHËRRËFYESE

Ne duhet t'i presim shenjat dhe të vazhdojmë të shpresojmë, sepse nuk janë shenjat ato që ndërtojnë ngjarjen. Allahu i Lartësuar me dëshirën dhe vullnetin e Tij ka vendosur të dhëna, procedura dhe kushte për vërtetimin e këtij premtimi hyjnor. Një nga kushtet më të rëndësishëme është përgjegjësia e njerëzimit. Shenjat na tregojnë edhe afërsinë e distancës dhe të arritjes, kurse shenjat e veçanta tregojnë kohën e afërt (me një muaj ose një javë, ose deri edhe në një ditë).

Shenjat na orientojnë që të ecim në rrugën e drejtë, në qartësi dhe dëshmi të saktë, na qartësojnë edhe të ardhmen. Ky është një kusht thelbësor për fitore dhe shpëtim.

Çështja e fundit që duhet sqaruar është se si të sillemi me këto shenja, me këto hadithe dhe transmetime. Këtë do ta diskutojmë më poshtë, në dashtë Allahu i Lartësuar.

Falënderimi i takon Allahut Zotit të botëve!

HULUMTIMI I TRETË

KRITERET METODIKE NË STUDIMIN E SHENJAVE TË SHFAQJES DHE ZBATIMI I TYRE²⁶

Hyrje

Arritëm te pika shumë e rëndësishme, te rezultatet të cilat dëshirojmë të arrijmë me diskutimin e transmetimeve që flasin për lajmet e së ardhmes, që flasin për ato që do të ndodhin në fundin e kohës duke shkuar deri në çështjen e Imamit të shumëpritur (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

²⁶ Fjala e eminecës së tij të nderuarit Hasan Nasrullah (Zoti e ruajtë!) në mexhllisin e muajit Muharrem, nata e nënëtë e muajit Muharrem i vitit 1436 h - 2/11/2014

METODIKA E PUNËS NË TEKSTET E TRADITËS SË BEKUAR PROFETIKE

Pasi njihemi me lajmet prej të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), duhet të shikojmë se cili është burimi që i ka trasmetuar këto lajme prej të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Duhet të sigurohemi, në bazë të rregullave shkencore islamike, nëse këto transmetime janë të pranueshme dhe nëse lejohet të mbështetemi në to.

Do të përpiqemi ta bëjmë më të thjeshtë bisedën duke shmangë sa më shumë terminologjinë shkencore.

Çdo hadith që trasmetohet ka një tekst dhe një varg transmetimesh. Unë kam mësuar përmendësh një hadith të njërit prej dijetarëve të mëdhenj. Prej tij më mbeti në mendje, vargu i trasmetuesve të tij. Njëri prej trasmetuesve të hadithit ishte Ebu Hasani, i cili thoshte: “... me të vërtetë se bukuria më e mirë është morali i mirë.”²⁷ Dhe me këtë transmetim janë dakortësuar një numër i madh transmetuesish.

²⁷ Lexo: el-Khisal, ibn Babeuejh, Muhamed bin Ali, Tahkik ue Tas-hih: Ali Ekber Gafari, botuesi: Xhemaatul muderrisin, Kum, data e botimit: 1403 h; botimi: i parë, faqe 29.

Dijetarët e muslimanëve kanë rënë dakord se çdo gjë që është trasmetuar nga Ehli Bejti dhe nga i Dërguari, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), jo domosdoshmërisht janë lajme të vërteta. Ata nuk thonë se me të vërtetë ne nuk e kemi për detyrë që të ndjekim dhe të jemi preçiz... Ka një pajtueshmëri të muslimanëve se ka hadithe që janë të vërteta, të pavërteta, të pranueshme dhe të dobëta.

Ata janë të dakordësuar gjithashtu, se edhe gjatë jetës së të Dërguarit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), edhe pas vdekjes së të Dërguarit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka pasur njerëz që kanë shtuar hadithe dhe ia kanë atribuar Pejgamberit, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Për këtë arsye dijetarët e “shkencës së trasmetuesve të haditheve” dhe dijetarët e “shkencës së hadithit” i kanë lënë mënjanë hadithe të tilla, derisa të verifikohen, të shqyrtohen dhe të sqarohen. Për shembull, trasmetohet nga filani se ai ka mësuar përmendësh njëqind mijë hadithe. Dijetarët tanë nuk e pranojnë se të gjitha hadithet e tij janë të vërteta dhe askush prej muslimanëve nuk i trajton të gjitha hadithet njësoj, si të ishin të vërteta apo të dobëta, dhe se duhet të mbështetemi tek ato hadithe.

Prandaj, ata i japin shumë rëndësi studimit të vargut të trasmetuesve të hadithit. I japin rëndësi atij që trasmeton dhe atij prej të cilit transmeton. I japin rëndësi besnikërisë dhe sinqeritetit të transmetuesit dhe vargut të

transmetuesve. Për këtë arsye ata studiojnë shkencën e vargut të trasmetuesve të hadithit dhe shkencën e hadithit që të japin një gjykim për të. Kjo punë bëhet nga studiues seriozë e specialistë.

METODOLOGJIA RACIONALE NË MARRJEN E LAJMEVE

Nëse dëshirojmë të thjeshtojmë problemet, këtë do ta bëjmë duke u siguruar se prej kujt e marrim lajmin, para se t'i besojmë atij. Duhet të sigurohemi për vërtetësinë e burimit të lajmit.


Për shmebull, nëse lajmëtari është një gënjeshtar, të paktën do të sigurohemi për fjalën e tij para se ta besojmë atë, edhe sikur të të lajmërojë një person i panjohur se vëllait tënd i ka ndodhur kështu apo ashtu, apo sepse në shtëpinë tënde ka ndodhur kjo gjë, ti nuk duhet bazohesh menjëherë në informacionet fillestare, përkundrazi, pikësëpari duhet të sigurohet vërtetësia e lajmit.

HADITHET E FABRIKUARA

Në jetën e zakonshme njeriu pranon si lajme të besueshme vetëm prej atyre të cilëve u beson. E njëjta gjë ndodh edhe me hadithet, veçanërisht ato që kanë lidhje me ligjet e fesë sonë, me sheriatin, me luftën, me moralin, me agjërimin dhe namazin tonë. Lajmi që sjell një person i çfardoshëm, qoftë edhe për diçka të thënë prej të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), nuk do të thotë se ajo është një çështje e pranuar dhe për t'u besuar.

Kjo merr vlerë të veçantë kur është fjala lajmet e së ardhmes. Në këtë fushë kërkohet më tepër saktësi dhe përpikmëri, sepse dijetarët i kanë dhënë zgjidhje të padiskutueshme këtij aspekti të haditheve.

Specialistët e kësaj fushe thonë se në këto fusha janë futur më shumë hadithe të fabrikuara. Luftërat dhe trazirat kanë krijuar mundësi që një pjesë e shkrimeve të jehudive të hyjnë në islam dhe më vonë kanë trasmetuar histori prej lajmeve të jehudive dhe ato ia kanë atribuar të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Ka edhe raste që nuk ia kanë atribuar atij, mirëpo një pjesë e tyre i kanë trajtuar ato lajme sikur të jenë lajmërimet nga pejgamberët, (Paqja qoftë mbi ta!) dhe kjo është e papranueshme.



Që lajmi të jetë i pranueshëm duhet të jetë trasmetuar nga personalitete të njohur e të besueshëm. Kjo do të ishte një arsye që të mund të thuhet se transmetimi i tyre është i vlerësuar dhe i vërtetë.

Le të vijmë tani te kuptimi i tekstit dhe i hadithit e të tjera si këto.

Këshilla e parë për të gjithë besimtarët është që të mos marrim si të vërtetë çdo informacion prej çfarëdo lloj libri që na bie në dorë, të mos marrim si krejt të sigurtë çdo transmetim që flet për fundin e kohës. Pra, të jemi të kujdesshëm para se të mbështetemi tek ato lajme.

Dihet, tashmë se ka shumë hadithe të fabrikuara, shumë hadithe që nuk kanë zinxhir trasmetuesish apo që të mund t'i kenë trasmetuar njerëz të panjohur. Për këtë arsye nuk mund të mbështetemi tek ato hadithe.

ÇËSHTJA QË I PËRKET MEHDIUT DHE RREZIKU I NDËRLIDHJES

Mbështetur në lajmet që vijnë nga tekstet e haditheve dhe transmetimet e njëpasnjëshme, themi se tema e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) është e padiskutueshme. Kështu ne shiitët e besojmë se Muhamed bin Hasan është prej sojit të Hyseinit, (Paqja qoftë mbi të!) dhe pasardhës i të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) Për këtë ekzistojnë transmetime të gjithë muslimanët.

Fakti se origjina e Imam Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) është prej djemve të Fatimesë, (Paqja qoftë mbi të!) duket si diçka e pajtuar, pasi origjina e Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) nuk pranon asnjë debat.

Për Sufjaniun ka shumë transmetime.²⁸ Mund të thuhet se origjina e Sufjaniut ka nevojë për një studim me

²⁸ Lexo shejh Sadukun, ibn Babeujj, Muhamed bin Ali, el-Khasalu, Tahkikun ve tas'hihun Ali Ekber Gafari, botuesi: Xhemaatul muderrisin, vendi i botimit: Kum, data e botimit 1403 h; botimi i parë; vëll 1, faqe 303. Transmetohet nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) se ka thënë: "Pesë gjëra do ndodhin para Kijametit, është dalja e Jemeniut dhe Sufjaniut dhe thirrësi që thërret nga qielli dhe fundosja në shkretëtirë dhe vrasja e të pafajshmëve".

të hollësishëm, sepse ka transmetime të dobëta që janë prezente në librat e muslimanëve.

Origjina e daljes së Jemeniut. Në transmetime kjo çështje është e qartë. Për të trajtuar temën e britmës do të fokusohemi në pesë ose gjashtë shenja.

Ka shenja që kanë shumë detaje. Në qoftë se duam të përqëndrohemi te çdo shenjë, do të shohim se ka dhjetëra transmetime që flasin për të. P.sh. britma apo klithma që vjen nga qielli, tmerri që vjen prej qiellit, fundosja në shkretëtirë e ushtrisë së Sufjanit që doli nga Medineja për të shkuar drejt Mekës.

Madje transmetimet kanë folur edhe për bamirësin e nderuar që del para protagonistit të kohës (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Por edhe ndaj këtyre transmetime kujdesi është i domosdoshëm, lidhur me vërtetësinë e lajmit dhe të transmetimit, sepse këto informacione, si çdo informacion mund të përdoret edhe për punë të mira, edhe për punë jo të mira.

PRETENDIM PËR MEHDIUN

Qysh prej ditëve të sundimit të beni abasitëve e deri tani ka patur shumë njerëz që kanë pretenduar se ata janë Mehdiu.²⁹ Kjo nuk është fare e vërtetë, sepse Mehdiu i premtuar sipas transmetimeve është ai që *"...do e mbushë tokën me drejtësi, sepse ajo është mbushur me padrejtësi e mizori..."*³⁰ Dhe kjo është përmendur në ajetet kur'anore kur është diskutuar për shtetin e drejtësisë. Ndërkohë, asnjë prej atyre që kanë dalë dhe janë hequr si Mehdiu, nuk kanë realizuar shtetin e drejtësisë mbi tokë.

Në vitin 1979, më 20 nëntor, disa muaj pas triumfit të Revolucionit Islamik në Iran (në kalendarin hënor i korespondon 1 Muharrem 1400 h, do me thënë dita e parë e vitit të parë hënor të shekullit të ri hënor 1400) dy personalitete mblodhën njerëz të armatosur dhe u tubuan

²⁹ Lexo: El-Mufidu, Muhamed bin Muhamed, el-Irshadu fi ma'rifeti huxhexhil-lah fil ibad, Tahkik ue Tas'hih: Fondacioni Alul Bejti a.s, botuesi: Mu'temeru shejh el-Mufid, Kum, data e botimit: 1423 h, botimi: i parë, vëll 2, faqe 369 dhe në të thuhet: *"Dalja e gjajshtëdhjetë mashtruesave ku secili prej tyre pretendon se është profet dhe dalja e dymbëdhjetë vetëve nga Alu Ebi Talibit ku secili prej tyre pretendon për veten e vet se është ai Imami"*.

³⁰ Lexo: "Kemaluddin dhe Temamu ni'mete" i Shejh Sadukut, Muhamed bin Ali bin Babeuejhi el-Kummi; Tahkik ve tas'hih ue ta'lik: Ali Ekber Gafari, botuar: Muharrem 1405 h; botoi dhe publikoi: Fondacioni i përhapjes islamike ndjekëse e xhematit të mësuesve në Kum, faqe 258.

në Xhaminë e madhe të Mekës në Qabe. Njëri prej tyre quhej Xhuhejman Atibi, kurse tjetri quhej Muhamed bin Abdullah Kahtani. Xhuhejmani i ftoi njerëzit e armatosur që ishin bashkë me të t'i jepnin besën Muhamed bin Abdullah Kahtanit me pretendimin se ai është Mehdiu i premtuar. Aty u bë një betejë dhe Kahtani u vra, kurse Xhuhejmani u arrestua dhe u var në litar më pas. Kjo ndodhi pas triumfit të Revolucionit Islamik në Iran, kështu që ka mundësi të ndërlidhet me historinë e flamujve të lindjes kur Khorasaniu ka dalë në Iran, kurse Mehdiu ka dalë në Mekë. Kjo është një çështje e kaluar përsa i përket kohës, kushteve, incidentit dhe afatit kohor. Ajo është prezent dhe do të mbetet prezent.

Në transmetimet e përmendura nga i Dërguari më i nderuar, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), thuhet se do të ketë njerëz që do të pretendojnë se janë Imam Mehdiu (dhe prej tyre do të frikësohen njerëzit me pozitë), sepse kushti është që ai të jetë i lindur nga djali i Fatimesë dhe djali i Hasanit dhe i Hyseinit. Nëse emri i ndonjërit prej tyre është Muhamed dhe i babai të vet Hasan i bënte shumë persona të pretendojnë se janë Mehdiu në Iran.³¹

³¹ Nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) thuhet se ka thënë: *"Nuk do të dalë i vërteti derisa para tij të dalin dymbëdhjetë vetë nga fisi beni Hashimij dhe ku secili prej tyre të pretendojë për veten e tij..."*. lexo el-Gejbetu i Tusit faqe 428 dhe 437; l'lamul Uera, faqe 426 dhe e ka trasmetuar el-Mexhlisij në el-Bihar, vëll 52, faqe 47 dhe 209.

Në kohën e beni abasitëve ky problem është hasur më shumë, kurse pretendimet e pasardhësve të Sufjanit janë më të pakta. Kjo për arsye se flamuri i tij është humbje dhe disfatë për bashkimin e muslimanëve. Përshtypja e përgjithshme është se personalitetet e mira mund që ta pretendojnë atë.

Mjafton të thuhet se ai që ka pretenduar se është Mehdiu, se është i Khorasanit, se është i Jemenit, se është shpirti i pastër nuk ka dhënë asnjë argument. Po cili është argumenti i tij? Asgjë nuk merret si e vërtetë pa u argumentuar. Personi që pretendon nuk prezanton asnjë argument që të tregojë se posedon dituri. Kjo ka ndodhur historikisht.

Në qoftë se marrim lajmin, shenjën, personin dhe premtimin kjo ngjarje do të bëhet në fundin e kohës, atëherë, pa dyshim që kjo çështje ka nevojë për kujdes dhe vëmendje të veçantë, sepse ndoshta kjo është njëra nga dobitë e hadithit për shenjat, për kuptimin e tyre dhe kuptimin e lajmeve të fundit të kohës.

RREZIQET E NDËRLIDHJES SË SHENJAVE TË SHFAQJES

Një nga problemet më të rrezikshme është ndërlidhja e shenjave. Thënë me fjalë të tjera, edhe po të jetë realizuar shenja, edhe personaliteti i përmendur në transmetime të jetë i njohur, përsëri këto mbeten pretendime, sepse shumë gënjeshtra të tilla të pretenduesve janë vërtetuar përgjatë historisë. Ndonjëherë njerëzit pretendojnë dhe pohojnë përputhjen e ngjarjeve dhe të personaliteteve bashkëkohore, por këto personalitete nuk e pretendojnë këtë gjë.

Më sipër sqaruam se ndarja e parë përmbledhëse lajmet e përgjithshme për të cilat ka folur i Dërguari, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) për fundin e kohës, për udhëheqësit, për xhamitë, për zakonet, për traditat, për mbretërit dhe princat, për gratë dhe Kur'anin, për situatat universale, për luftërat dhe sëmundjet. Mirëpo ai nuk i ka lidhur këto hadithe me ardhjen e Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Në kohën tonë një pjesë e tyre janë realizuar pa asnjë ndryshim dhe kjo nuk kundërshtohet nga askush.

Për shembull, hadithi që thotë se: *"... burrat do të zbukurohen me veshje grashë, kurse gratë do të vishen si burrat..."* është i vërtetuar, shkatërrimi i mbretërisë së beni

Umejeve dhe mbretërisë së beni Abasitëve është realizuar gjithashtu dhe për këto nuk ka asnjë diskutim. Siç shihet, një pjesë e madhe e këtyre lajmërimeve janë realizuar dhe vërtetuar.

Pjesa e dytë e shenjave janë ato që kanë lidhje me shfaqjen haptazi, por që nuk pëcaktojnë kohën e shfaqjes. Këto janë shenja të përgjithshme. Për shembull, mund të thuhet se janë shenja të përgjithshme shkatërrimi i mbretërisë së beni Abasitëve ose transmetimet ezkistuese që thonë se dituria rrjedh në Kufe dhe lulëzon në një vend që quhet Kum.³² Mirëpo kur do të ndodhë kjo gjë? Kjo gjë nuk dihet. Pra, disa shenja të përgjithshme janë realizuar, kurse një pjesë tjetër akoma nuk janë realizuar deri tani.

Pjesa e tretë trajton shenjat e veçanta. Me fjalë të tjera ajo që është cituar në transmetimet janë të lidhura me shfaqjen hapur të Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Ata janë të një forme të veçantë: pasardhësi i Sufjaniut, i Jemenuit, i Khorasaniut, britma në qiell, fundosja në shkretëtirë. Për të gjitha këto ka një kohë, ka një ditë të caktuar, ka një muaj të vetëm.³³ Për shembull, britma, flitet

³² Lexo: el-Mexhliisij, Muhamed Bakir bin Muhamed Tekij, Biharul Enuar, botuesi: Daru Ihjai Turathil arabij, data e botimit 1403 h, botimi: i dyti, vëll 57, faqe 213.

³³ Nga Ebi Abdillahi (Paqja qoftë mbi të!) që ka thënë: “Dalja e tre shenjave, i pasardhësve të Sufjanit, të Jemenit dhe Khorasanit në të njëjtin vit, të njëjtin muaj të njëjtën ditë dhe nuk ka flamur më të udhëzuar se flamuri i Jemenasit sepse ai bën thirrje drejt të vërtetës së fshehur (Imam Mehdiu)” i Nu’maniut, faqe 255 e më pas; el-Gejbetu i

se ndodh në muajin Rexhep dhe në muajin Ramazan. Mund të jetë vetëm një britmë, ose mund të jenë disa britma njëherazi.

Dihet edhe fundosja në shkretëtirë kur shkonin nga Medineja në drejtim të Mekës për të izoluar Imam Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!).

Problemi qëndron në sinkronizimin dhe koherencën e lajmeve dhe kohës së realizimit të tyre.

Nuk dihet koha kur do të realizohet shenja, kur do të ndodhin këto ngjarje? Po kush është ai që ka informacion për këtë?

Askush nuk mund ta pretendojë këtë gjë, vetëm nëse ka personalitete të veçantë që kanë marrë dije nga i Dërguari i Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), e cila nuk ka arritur tek ne.


Këtë ndërlidhje nuk e shoqëron shfaqja e Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!). Problemi vështirësohet kur disa persona vijnë për të ndërlidhur karakteristikat e transmetimeve me persona ekzistues në realitet, sepse ato shenja nuk përputhen me daljen e Imam Mehdiut dhe me shtetin e të drejtës. Ata persona thonë se udhehqësia e drejtës hyjnore do të vijë pas një viti. Prandaj dëshërojmë të qartësojmë rreziqet që lidhen me këtë çështje. Këtë do ta bëjmë në pjesën e tretë.

Tusit, faqe 443 dhe 446; I'lamul Ueraa, faqe 429, e ka trasmetuar el - Mexhlisij në El-Bihar, vëll 52, faqe 210.

A mund të ketë ndërlidhje pa njohuri dhe dije? Në qoftë se u them njerëzve se ky person është pasardhës i Sufjaniut, kuptohet se u kam thënë që Mehdiu (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) do të vijë pas gjashtë muajsh, pas pesë ose tre muajsh, sepse kështu thuhet në transmetime. Në qoftë se u them njerëzve se ky person është jemenas ose khorasanij apo se klithma që dëgjuam mbrëmë në darkë është britma e qiellit, kjo duket sikur unë u thëm priteni Mehdiun (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) pas një ose dy javësh. Pikërisht këtu është rëndësia e kësaj teme. Prandaj themi se duhet parë me shumë kujdes sinkronizimi dhe ndërlidhja. Kur ndërlidhja e disa titujve apo emërtimeve me personalitete të caktuar bëhet pa u mbështetur në informacione të sigurta rezulton e gabuar. Këto janë supozime dhe supozimet nuk i shërbejnë të vërtetës. Ne nuk e dimë mirë se ky është vërtet Jemaniju apo Khorasaniju apo Sufjaniju.

Çorientimi i njerëzve: Një nga rreziqet e kësaj ndërlidhjeje është çorientimi i njerëzve, sepse kur përcjell një informacion të pakonfirmuar shkakton kofuzion e paqartësi.

Çështja më e rrezikshme është të ngjallësh dyshime për çështjen e Imam Mehdiut dhe shenjat përkatëse. E rrezikshme është edhe ndërlidhja e titujve dhe adresimeve me njerëzit, të cilëve nuk u takojnë ato tituj. Kjo gjë vërtetohet kur vdes personaliteti në fjalë. Këto krijojnë paqartësi dhe dyshime në ardhjen e Imam Mehdiut. Ky është gabimi që sjellin ndërlidhjet e gabuara.



Gabimi në ndërlidhje të ngjarjeve ekziston në çdo kohë. Ato bëhen ose për përfitim, bëhen që një pjesë e tyre të përçojnë legjitimitetin për atë që duan, bëhen që librat e tij të bëhen të famshëm, etj. Kështu, çështja merr vlera biznesi, por kjo gjë sjell rreziqe shumë të mëdha. Prandaj, theksojmë se ndërlidhja e gabuar është gjynah dhe ka shumë rreziqe të mëdha.

MODELE TË RREZIQEVE TË NDËRLIDHJES NË KOHËN E SOTME

Dikur është thënë se Sufjaniu është Sadam Huseini dhe se ai ka bërë kështu e kështu. Tani Sadam Hyseini ka vdekur do me thënë Sufjaniu ka ikur. Çfarë të bëjmë ne? Gjithashtu, në Irak ka një shembull tjetër: shumë njerëz kanë thënë se të Ebu Musab Zarkavi, i cili ka akuzuar, ka vrarë, ka prerë dhe ka derdhur gjak është Sufjaniu. Kjo mbështetej në shfaqjen e flamurit të Sufjanit. Çështja u vu në dyshim, sepse është thënë që Sufjaniu del nga zona e quajtur “lugina e thatë”, e cila është e vendosur në një trekëndësh midis Sirisë, Jordaninë dhe Palestinës. Por edhe Zarkavi tani ka vdekur. A erdhi shteti i së drejtës hyjnore?

Problemi është se ata e edukojnë botën për këtë çështje dhe tani Ebu Bekër Bagdadi, (lideri i Daeshit) është quajtur nga disa njerëz Sufjaniu. Sipas disa transmetimeve para dy ditësh ai ka vrarë shtatëdhjetë persona synitë prej fisit Ebu Nemr. Sipas disa transmetimeve të tjera numri i të vrarëve është dyqind apo treqind burra, gra dhe fëmijë.

Pati një kohë që shumë njerëz u ndikuan nga flamuri i Iranit. Njerëzit filluan të thonë se Khomeini është Khorasaniu dhe e vlerësonin, e nderonin, e quanin fisnik. I

gjithë Irani konsiderohet Khorasan. Khomeini dhe Kumi janë pjesë e Khorasanit. Imam Khomeini quhej se është Khorasaniu dhe është ai që do i dorëzojë flamurin Imam Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!), por Allahu bëri që ai ndërroi jetë.

Tani, një pjesë e tyre mund të thonë se eminenca e tij, i nderuari udhëheqës është Khorasaniu. Edhe unë jam personi që dua më shumë se të gjithë që realiteti të jetë i tillë, por me çfarë argumenti? Mbi çfarë baze? Ku është konteksti?

Ndonjëherë ne mund të bëjmë ndërlidhjen e disa cilësive të disa personave me kontekste të caktuar, por gjithsesi kjo mbetet në rrethin e supozimit dhe jo të diturisë dhe bindjes, besimit.

Edhe për çështjen e jemenasit ka shumë pretendime. Në Irak për shembull, ka dy ose tre persona që pretendojnë se janë jemenasi.

Edhe në Liban, disa dashamirës të hizbullahut kanë pretenduar se flamuri i Hizbullahut është flamuri i Jemeniut dhe se filani është Jemeniu³⁴.

³⁴ Eminenca e tij ka për qëllim veten e tij do me thënë se disa dashamirës pretenduan se emineca e tij është ai Jemeniu.

Ah, sikur të ishte kështu! Por cili është argumenti? Ajo që kërkohet prej nesh është që të mos mbajmë qëndrim për atë që nuk kemi dituri.

Thënë me fjalë të tjera, gabimet në ndërlidhje të çojnë drejt gabimeve të tjera. Përsëritja e gabimit në ndërlidhje të çon drejt dyshimit në të gjitha këto shenja. Pikërisht, gabimeve të këtij lloji ne duhet t'u qëndrojmë larg në mënyrë kategorike.

Nuk mjafton vetëm që nijeti, të jetë i mirë. Ky do të ishte një gabim që të çon drejt haramit.

Për shembull, ka mundësi që një person të thotë se një personaliteti iu shtua një lloj legjitimiteti dhe shenjtërie. Po a shtohen vlerat e dikujt vetë pse thua ti? Po a ka nevojë udhëheqësi i nderuar për shtimin e legjitimitetit?!

Legjitimiteti i tij është i bazuar në rregulla, në moralin e tij, në detyrat, në përgjegjësitë, në asketizmin e tij. Mençuria, trimëria dhe eksperiencia e tij e lartë janë ato që ia shtojnë, reputacionin, dashurinë dhe shenjtërinë tek besimtarët.

MËNYRA PRAKTIKE TEK HIZBULLAHU

Ka njerëz që thonë se lufta në Siri është lufta e Sufjaniut. Këtë ne nuk mund ta themi. Ne themi se legjitimiteti i luftës sonë mbështetet në bazat e fikhut dhe të shariatit, mbështetet në ato praktika dhe realiste dhe nuk është e nevojshme kjo lloj stisje.

Ne bëjmë rezistencë në Siri për të mbrojtur Libanin, Sirinë, Palestinën, rajonin dhe popujt e rajonit nga sundimi amerikan dhe izraelit si dhe sundimi i takfiristëve, të cilët, nëse marrin në dorë frerët e qeverisjes, do të bënin me ne atë që i bëri Ebu Bekër Bagdadi fisit Ebu Nemr.

Ka shumë mundësi që e gjitha kjo histori (historia e Khorasaniut, Jemeniut dhe Sufjaniut) të ndodhë pas pesëdhjetë vitesh. Në atë kohë ne nuk do të jemi prezent.

Ne nuk kemi nevojë për këtë, sepse ne kemi llogjikë, mendje, rregulla, ligje dhe institucione. Ne kemi Kur'anin dhe traditën profetike, kemi argumente. Ne e mbështesim lëvizjen tonë në moralin dhe perceptimin ligjor, e mbështesim në shariat dhe në përgjegjshmërinë tonë shariatike. Të gjitha tregimet që flasin për supozime dhe imagjinata, për parashikime, për falle me hedhje rëre dhe me filxhan, për astrologji etj. ne nuk i dëshirojmë. Ne

mbështetemi në njohuritë shkencore të teologjisë islame. Kjo mbështetje na bën të kujdesshëm dhe vigjilentë.

Nuk do të ishte shqetësues nëse njerëzit bëjnë supozime. Supozimet kthehen në shqetësim kur u serviren njerëzve si të vërteta definitive të cilat diskutohen edhe nëpër xhami. Ky është gabim. Ndaj këtyre gabimeve duhet të jemi të kujdesshëm.

KARAKTERISTIKAT E SHENJAVE TË VEÇANTA

Përcaktimi dhe qartësia që lidhet me shenjat e veçanta.

Sipas transmetimeve, kur të shfaqen shenjat e veçanta, të vërteta dhe të vlerësuara, do të shfaqen edhe Jemeniu, Khorasaniu dhe Sufjaniu, do të shfaqet britma në qiell dhe fundosja në shkretëtirë. Kur t'u afrohem këtyre shenjave ne nuk do të humbim. Mjafton që të kemi njohuri për këto shenja, të cilat do të jenë të njëpasnjëshme dhe ngjarjet që lidhen me to do të pasojnë njëra-tjetrën. Çështjet do të jenë shumë të qarta. Treguesi më i qartë i shenjës dhe gjëja më e rëndësishme që përmendet në disa transmetime është ardhja e një personi, të cilin ne nuk do ta njohim. Për këtë çast transmetimi thotë se çështja e Sufjaniut është e qartë dhe evidente. Megjithatë transmetimi plotëson më pas duke thënë se edhe po të mos e njihni çështjen e Sufjaniut, do ta njihni britmën e qiellit, sepse atë e dëgjon çdo vesh në mbarë botën në gjuhët e tyre përkatëse. Disa njerëz thonë se britma e qiellit nënkupton satelitët. Edhe ky supozim nuk qëndron, sepse nuk ka pjata satelitore në çdo vend të botës. Edhe sikur të ketë, shkenca nuk mund ta

bëjë dublimin dhe kthimin e sinjalit në të gjitha gjuhët e botës në të njëjtën kohë. Prandaj themi se britma në qiell ka një titull dhe një vulë mrekullie. Ajo është shenja vendimtare. Në qoftë se ne humbasim ndonjë shenjë, vjen britma, shenja më e qartë, që askush mos ta humbasë.

PËRCAKTIMI I KOHËS SË SHFAQJES

Tema e fundit e bisedës tonë është tema e përcaktimit të kohës. Disa njerëz hiqen sikur ta dinin të fshehtë. Ata thonë, p.sh. se ai del pas gjashtë muajsh, apo del ditën e xhuma etj. Të gjitha këto janë të pavërteta. Ai apo ata që e thonë këtë gënjejnë hapur. Imamët tanë na e kanë ndaluar ta themi këtë. Ata kanë trasmetuar se këtë ndalesë e ka trasmetuar i Dërguari i Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), në trasmetimin e Imam Sadikut (Paqja qoftë mbi të!) ku thotë: *“O babai i Muhamedit, vërtet ne jemi të Ehli Bejtit dhe nuk përcaktojmë kohë.”*³⁵ Pejgamberi Muhamed, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), ka thënë: *“... kanë gënjyer dhe mashtruar ata që përcaktojnë një kohë...”*³⁶ Kjo është vendimtare për ndalimin dhe mohimin e përcaktimit të kohës dhe përgënjeshttrimin e atyre që përcaktojnë një kohë. Për të qartësuar këtë ka trasmetime të shumta. Mes disa trasmetimesh përmendet një

³⁵ Ibn Ebi Zejnebi Nu'mani, el-Gejbetu: Faris Hassun Kerimi, botimi i parë, viti i botimit 1422 h, shtëpia botuese Mahr -Kum, botoi Envarul Huda, faqe 289.

³⁶ El-Kulejni, Muhamed bin Jakub bin Is'hak, el-Kafi, tahkik ve tas'hih: Ali Ekber Gafari dhe Muhamed Akhundi: botuesi: Darul kutubul islamiye, Teheran, data e botimit: 1407 h, botimi i katërt, vëll 1, faqe 368.

trasmtim nga Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) . Imam Sadiku (Paqja qoftë mbi të!) i ka thënë Muhamed bin Muslimit: *“O Muhamed, cilido prej nesh që të lajmëron për një përcaktim kohor, mos ngurro ta përgënjeshtrosh, sepse ne nuk i përcaktojmë afat kohor askujt.”*³⁷

Përcaktimi i kohës është një nga problemet më të rrezikshme të kësaj dosjeje. Ku mbështeten ata që pretendojnë se përcaktojnë kohën?

Në disa transmetime thuhet se çështja e shfaqjes është një dije specifike e Allahut të Lartësuar. Përveç Tij nuk e di askush tjetër! Kjo është dije prej dijes së Kijametit. Megjithkëtë ka disa njerëz që marrin guximin dhe flasin për caktim kohor, fabrikojnë skenare të daljes.

Mohimi i përcaktimit kohor, ndalimi dhe përgënjeshtrimi i tij në mënyrë kategorike është detyra e parë. Edhe nëse dikush prej nesh flet për caktim kohor ne duhet ta ndalojmë atë. Përcaktimin e kohës e di vetëm Allahu i Gjithëditur.

³⁷ Ibn Ebi Zejneb Nu'mani, el-Gejbetu, Thakik: Faris Hassun Kerimi, botimi i parë, viti i botimit 1422 h, shtëpia botuese Mahr -Kum, botim i Envarul Huda, faqe 289.

DËSHPËRIMI I NJERËZVE, (ZGJATJA E SHPRESËS)

Pas ndalimit të përcaktimit kohor, vjen për diskutim çështja e dytë. Çështja e dytë diskuton se çfarë bëjnë një pjesë e njerëzve me përcaktimin e kohës së ardhjes së Mehdiut (Allahu e shpejtoftë ardhjen e tij!) dhe formimin e shtetit të drejtësisë? Kjo është një çështje e gjatë, një çështje e largët. T'i lësh njerëzit në pritje, me shpresa të zgjatura është gabim.

Më parë kemi përmendur dobitë e shenjave. Kur Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!), përmendte shenjat dhe dobitë e shenjave, kur tregonte se çfarë do të ndodhë pas vdekjes së tij, kjo nënkupton se jemi afër fundit të kohës. Nëse ne themi se koha e daljes do të jetë pas të paktën 200 vjetëve dhe një person tjetër thotë se dalja do jetë javën e ardhshme, jemi në dy situata të pavërteta, të cilat nuk mbështeten në informacione të konfirmuara si të sakta. Këto situata sjellin rreziqe intelektuale, ideologjike dhe psikologjike, sepse të orientojnë drejt dëshpërimit dhe fshirjes së veprave ose drejt mohimit.

Po cili është trajtimi i drejtë për orientimin dhe transmetimet? Kjo është çështja e fundit.

PRITJA E SHËNDOSHË

Ne kemi besojm plotësisht në hadithet e ardhura nga Pejgamberi, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) dhe në atë që thuhet në Kur'an. Ne kemi një besim definitiv që e ardhmja e tokës është e ardhmja e superioritetit të njësimit, e superioritetit të fesë hyjnore dhe njerëzve të shtypur, se e ardhmja e tokës është e ardhmja e urtësisë, e prosperitetit dhe begatisë. Çdo gjë për të cilën kanë luftuar, kanë sakrifikuar dhe kanë sjellë pejgamberët e Allahut, (Paqja qoftë mbi të gjithë ata!) gjatë gjithë historisë, do të realizohet mbi standartin e dynjasë para standartit të Ahiretit.

Hadithet e të Dërguarit të Allahut, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!) që kanë ardhur deri tek ne dhe ato që janë vërtetuar si të vërteta dhe të pranuar, ne i presim dhe gjatë pritjes sonë ne nuk përcaktojmë kohë. Sjellja e duhur lidhur me çështjen që diskutojmë do të ishte pritja e çështjes mëngjes dhe darkë, pa u distancuar, sepse, ka mundësi të ndodhë çdo natë, çdo orë dhe çdo ditë. Gjithashtu, çështja i është nënshtruar vullnetit të Allahut të Lartësuar. Nëse Ai dëshiron që premtimin e Tij ta vërtetojë natën, atëhere natën e realizon. Allahu i Madhëruar e di se kur do ta

realizojë. Ajo mund të ndodhë pas pak orësh, ditësh, javësh, muajsh, apo vitesh. Ne nuk e dimë të fshehtën! Ne nuk kemi dituri për atë që di Allahu. Prandaj, ne duhet ta presim çështjen ditë e natë dhe ta lusim Allahun e Lartësuar që ta afrojë atë dhe ta bëjë më shpejt. Ky është kuptimi i drejtë.

REALIZIMI I PREMTIMIT HYJNOR ME DËSHIRËN E ALLAHUT

Ka mundësi që një pjesë e dijetarëve të thonë se kjo çështje nuk do të bëhet para Sufjaniut, Khorasaniut dhe Jemeniut, para britmës e kështu me rradhë. Këto diskutime kanë bërë që shenjat të ndahen në dy pjesë: në shenja të paevitueshme dhe në shenja të pezulluara, të evitueshme.

Por çdo gjë i është nënshtruar vullnetit të Allahut të Lartësuar. Kjo është e padiskutueshme. Ja ç'thuhet për këtë në Fjalën e Tij: **“Allahu shlyen (nga ajo evidencë) çfarë të dojë edhe forcon (çfarë të dojë).”**³⁸ Nuk mund të ketë kontroll ndaj vullnetit të Tij, ndaj diturisë dhe urtësisë së të Lartësuarit të Madhëruar. Edhe ajo që është jo përfundimtare i nënshtrohet kësaj. Sipas disa dijetarëve, edhe ajo që është definitive i nënshtrohen rregullit dhe ligjit të Tij. **“Allahu shlyen (nga ajo evidencë) çfarë të dojë edhe forcon (çfarë të dojë).”** Me fjalë të tjera është e mundur të ndodhë ose jo. Ka një transmetim ku pyetet Imam Xhevadi, (Paqja qoftë mbi të!): **“A është Sufjaniu i pashmangshëm?”** Ai ka thënë: **“Po, është i pashmangshëm.”**

³⁸ Sure "Rra'd", ajeti 39.

Imam Xhevadi tha përsëri: “A i nënshtrohet asaj që Allahu fshin dhe forcon çfarë të dojë nga evidencat?” Ai ka thënë: “Po.” Xhevadi tha: “Po Mehdiu a i nënshtrohet?” Ai tha: “Jo, sepse Mehdiu është pjesë e premtimit dhe Allahu nuk e thyen premtimin.”³⁹

Akoma një pjesë e njerëzve debatojnë transmetimin. Edhe sikur të themi se ajo që është e paevitueshme do të realizohet, edhe sikur detajet të jenë të evitueshme, përsëri ka mundësi që në një natë të vetme Allahu të nxjerrë Jemeniun, Sufjaniun dhe Khorasaniun, të nxjerrë Xhebrailin për britmën në qiell! Allahu jep leje që të dalë sheshazi miku i Tij i fshehur mes krijesave të Tij për realizimin e premtimit hyjnor.

Pra, duhet të kuptohet që njerëzimi të afrohet, të presë, të lutet, të përgatitet, të pajiset dhe ta presë këtë çështje natë e ditë.

³⁹ Ibn Ebi Zejneb Nu'mani, el-Gebetü, Takik: Faris Hassun Kerimi, botimi i parë viti i botimit 1422 h, shtëpia botuese Mahr-Kum, publikoi Envarul Huda, faqe 203.

SHPRESA DHE PRITJA

Shpresojmë se me këtë diskutim ideja është bërë më e qartë. Ky diskutim ka një shkallë të lartë ndjeshmërie në ditët tona, sepse shumë pseudoteologë përpiqen ta keqpërdorin atë politikisht, moralisht dhe ekonomikisht. Prandaj kërkojmë nga njerëzit të shpresojnë dhe të presin, në bazë të atyre që shpjeguem. Të jemi të kujdesshëm që ta trajtojmë këtë çështje duke u mbështetur në argumente shkencorë dhe të mos implikohet as nga trillimet, as nga legjendat dhe nga asnjë rrugë që të largon nga rruga e Allahut të Madhëruar.

Kështu ka vepruar Imam Hysejini (Paqja qoftë mbi të!), të cilin e ka lajmëruar gjyshi i tij, (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të dhe mbi familjen e tij!). Kjo histori është e njohur nga Umu Selme dhe Imam Huesini (Paqja qoftë mbi të!) ka marrë përgjegjësinë e tij.

Disa persona të gjithë punën e tyre e kufizojnë te mësimi i shenjave. Është e drejtë të mësohen shenjat, por ne kemi përgjegjësi dhe obligim të legjitimuar për të sqaruar gjithçka lidhet me to. Ky është një nga mësimet më të rëndësishme të Imam Hyesinit në Qerbala.

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE.....	5
HULUMTIMI I PARË.....	6
NJË PIKËPAMJE PËR MËNYRAT E NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË.....	6
DIJA E FSHEHTË DHE E ARDHMJA JANË NJË ÇËSHTJE E DEBATUESHME DHE E RËNDËSISHME.....	8
ÇFARË ËSHTË DIJA E FSHEHTË, GAJBI?.....	11
BESIMI NË GAJB, NË DIJEN E FSHEHTË ËSHTË PJESE E BESIMIT TONË.....	13
E FSHEHTA DHE DËSHMIA JANË DY ÇËSHTJE RELATIVE.....	14
DITURIA PËR TË FSHEHTËN.....	15
MËNYRAT E BESUESHME TË NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË.....	17
MULTIMËNYRAT E NJOHJES SË DIJES SË FSHEHTË....	19
ËNDRRAT DHE LIDHJET E TYRE ME TË ARDHMEN...24	
A JANË ËNDRRAT PROVË, ARGUMENT?.....	27
PËRSE ALLAHU I MADHËRUAR E KA MBYLLUR DERËN E DIJES SË FSHEHTË?.....	28
SI TI MËSOJMË LAJMET E SË ARDHMES?.....	30
HULUMTIMI I DYTË.....	31

PIKËPAMJA E ISLAMIT PËR LAJMET E DIJES SË FSHEHTË DHE TË ARDHMEN.....	31
KUR'ANI DHE TRADITA PROFETIKE JANË DY BURIME TË RËNDËSISHME TË DIJES SË FSHEHTË.....	31
KUR'ANI FISNIK DHE LAJMET QË PËRCJELL PËR TË ARDHMEN.....	33
E ARDHMJA E NJERËZVE PUNËMIRË.....	36
UDHËHEQJA HYJNORE DHE E ARDHMJA E TË MIRËVE.....	38
LAJMET E SË ARDHMES NË TRANSMETIME.....	40
NDARJA E TRANSMETIMEVE LIDHUR ME TË ARDHMEN.....	41
DOBIA E MËSIMIT TË LAJMEVE TË SË ARDHMES.....	46
DOBI IDEOLOGJIKE.....	47
VËRTETIMI I PROFETËVE.....	48
DOBI PSIKOLOGJIKE.....	50
NJË DOBI PARAPËRGATITORE PËR TË ARDHMEN.....	52
AFRIMI I SHPRESËS.....	55
SHENJAT JANË UDHËRRËFYESE.....	56
HULUMTIMI I TRETË.....	57
KRITERET METODIKE NË STUDIMIN E SHENJAVE TË SHFAQJES DHE ZBATIMI I TYRE.....	57
METODIKA E PUNËS NË TEKSTET E TRADITËS SË BEKUAR PROFETIKE.....	58
METODOLOGJIA RACIONALE NË MARRJEN E LAJMEVE.....	61
HADITHET E FABRIKUARA.....	62

ÇËSHËTJA QË I PËRKET MEHDIUT DHE RREZIKU I NDËRLIDHJES.....	64
PRETENDIM PËR MEHDIUN.....	66
RREZIQET E NDËRLIDHJES SË SHENJAVE TË SHFAQJES.....	69
MODELE TË RREZIQEVE TË NDËRLIDHJES NË KOHËN E SOTME.....	74
MËNYRA PRAKTIKE TEK HIZBULLAHU.....	77
KARAKTERISTIKAT E SHENJAVE TË VEÇANTA.....	79
PËRCAKTIMI I KOHËS SË SHFAQJES.....	81
DËSHPËRIMI I NJERËZVE, (ZGJATJA E SHPRESËS).....	83
PRITJA E SHËNDOSHË.....	84
REALIZIMI I PREMTIMIT HYJNOR ME DËSHIRËN E ALLAHUT.....	86
SHPRESA DHE PRITJA.....	88

اسم الكتاب: الإمام المهدي و أخبار الغيب

المؤلف: السيد حسن نصرالله

المترجم: ولنت مربيا

التصحيح اللغوي و الأدبي: اسعد بونغوري

التدقيق: صبريه فزا

الاخراج النهائي و تصميم الغلاف: صبريه فزا

ناشر: جمعية النسيم - تيرانا - ألبانيا